REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.Prot 0604 Kuçovë, më 24/12/2019

VENDIM
Nr. 43, dt. 24.12.2019

PËR
MIRATIMIN E PBA PËRFUNDIMTAR 2020-2022

Këshilli Bashkiak pasi shqyrtoi materialin e paraqitur i cili është në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 6, 7, 40, 41 të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenë 6, 15, 17, 24, 32. i ndryshuar, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 6/1, dt. 28.02.2018, " Për përgatitjen e Buxhetit Vendor", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 23 dt. 30.07.2018 " Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetë qeverisjes Vendore;

VENDOSI:

1. Miratimin e PBA përfundimtar 2020-2022 (viti i parë i të cilit është buxheti i vitit 2020) sipas dokumentacionit bashkëlidhur.
2. Miratimin e kalendarit të buxhetit vjetor dhe PBA 2021-2023.
3. Ngarkohet për zbatim GMS dhe Njësitë Shpenzuese.

Ky vendim u miratua me: 23 vota pro, — vota kundër, — abstenim të pranishëm 23 këshilltare.

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK
Migena BULLARI

BASHKIA KUÇOVË

BUXHETI AFATMESËM

2020-2022

DBJETOR 2019

Bashkia Kuçovë

PËRMBAJTJA

Kapitulli I. Informacion i përgjithshëm mbi Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2020-2022

1. Hyrje
2. Qëllimet e PBA
3. Objektivat e PBA
4. Kush përfshihet në PBA.
   (Referenca PPV)

Kapitulli II. Plani Financiar i Bashkisë Kuçovë 2020-2022

Kapitulli III. Programet Buxhetore Afatmesëm

1. PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM (01110),
2. ÇËSHTJE FINANCIARE DHE FISKALE (01120),
3. SHËRBIME TË PËRGJITHSHME VENDORE (03140),
4. MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE (03260),
5. SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI, USHQIMI DHE MBROJTJA E KONSUMATOREVE (04220),
6. PROGRAMI I MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURES NË UJITJE DHE KULLIM (04240),
7. ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE (04260),
8. MIRËMBAJTJE RRUGË TROTUARE (04520),
9. MENAXHIMI I MBETJEVE (05120),
10. MBROJTJA E MJEDISIT (05610),
11. PLANIFIKIMI URBAN DHE STREHIMI (06140),
12. SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE (GJELBËRIMI, MIRËMBAJTJE VARREZASH PUBLIKE, DEKORI, (06260),
13. NDËRTIMI RRUGOR (06440),
14. SPORTI (08130),
15. ARTI DHE KULTURA (08220),
16. PROGRAMI I ARSIMIT BAZË DHE PARASHKOLLOR (09120) ,
17. ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM (09230),
18. QENDRA DITORE PËR TRAJTIMIN E AFTËSI NDRYSHE (10140),
19. ÇERDHE (10430),
20. PROGRAMI I MBROJTJES SOCIALE (10430),

Kapitulli IV. Alokimi i Fondeve sipas Programeve

Kapitulli V. Financime nga partnerë dhe donatorë.

KAPITULLI I

Vështrim i përgjithshëm:

Misioni i Bashkisë Kuçovë: *Bashkia Kuçovë, përtej qëllimit ekonomik, synon të të krijojë një mjedis shoqëror të shoqërizohem nga i cili përfiton i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët mbizotëron; ku banorët jetojnë në harmoni me burimet natyrore, institucionet publike dhe komunitetet e tjera që e rrethojnë, sot e në vazhdim*

Bashkia Kuçovë është pjesë e qarkut të Beratit, dhe shtrihet në pjesën lindore të Ultësirës Perëndimore, e kufizuar në veri dhe veriperëndim nga zona e Sulovës dhe lumi Devoll, e në jug e jugperëndim nga trojet e lumit Osum. Me një sipërfaqe prej, 160.22 km², territori i Kuçovës së sotme e tejkalon atë të rrethit të Kuçovës, duke përfshirë nën juridiksionin e saj edhe njësinë administrative Lumas, dikur njësive Kuçovë (qendër), Perondi e Kozare. Nga pikëpamja administrative, Kuçova kufizohet me bashkitë Lushnje, Belsh, Cërrik, Gramsh, Berat dhe Ura Vajgurore.

Me një popullsi prej 55,518 banorësh (referuar regjistrit të gjendjes civile Dojcior 2016) dhe 55,170 banorë (referuar regjistrit të gjendjes civile Dhjetor 2017) dhe 55,770 banorë (referuar regjistrit të gjendjes civile Dhjetor 2018). Kuçova ka një ndër dendësitë më të larta në rajonin e Shqipërisë Qëndrore, me 348 banorë/km². Rreth 80% e kësaj popullsie është vendosur në qytetin e Kuçovës, dhe në njësitë administrative Perondi. Bashkia ka një administrim të saj 31 fshatra dhe një qytet.

Bashkia Kuçovë

Sipërfaqja e tokave bujqësore në territorin e bashkisë Kuçovë është 84 km², sipërfaqja më e madhe e të cilës zihet me livadhe natyrore 36.59 km² dhe nga toka arë e kultivuar me fusha të ndryshme vaditurash bujqësore 29.11 km².

Territori i bashkisë së ka mbulim të plotë me **shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve** Kuçovë, SHAUK ofron shërbimin në bashkinë Kuçovë dhe njësitë administrative Perondi, Kuzarë, ndërsa në njësia administrative Lumas është e paprunduar me shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm UK Kuçovë furnizohet me ujë nga burimi i Bogovës afër si dhe bashkia Berat dhe nusel e Pashes së Devollit të cilat kanë zonë me një fshatrat Tapi, Drizë, Gërvaj, Velagoshtë Gegë dhe Poloviné. Sasia e ujërave që shfrytëzohet nga burimi i bogovës është mesatarisht 200l/sek ne periudhën e dimrit deri në 150 l/sek në periudhën e verës. Sasia totale furnizimi i Bogovës dhe pusit e Devollit) mesatare e ujit që shfrytëzohet nga ndërmarrja e ujësjellës – kanalizimeve në bashkisë Kuçovë është 692.5 l/sek.
Bashkia e Kuçovës ka një **rrjet të pasur ujor**. Në veri-perëndim, për rreth 12.5km Bashkia përshkohet nga rrjedha e mesme e lumit Devoll i cili bashkohet me Lumin Osum në Ares të Urës Vajgurore.
Në Kuçovë ndodhen edhe një numër rezervuarësh midis të cilëve numëroj të përmendim ujëmbledhësin e Gorajt në pjesën qendrore të bashkisë, ujëmbledhësin e Retesovës në pjesën perëndimore. Ujëmbledhësin ndërmjet fshatrave Gegë dhe Drizë dhe ujëmbledhësin në Salcë-Kuzarë. Një sërë përrenjsh të vegjël përshkruajnë pothuajse të gjithë territorin e bashkisë të cilët shërbejnë si burime ushqyese të lumenjve të mësipërm Osum, e Devoll. Burimet ujore sipërfaqësore janë të rëndësishme për funksionet e tyre të përgjithshme (për ujitje, etj.) dhe mbi të gjitha, sëto shërbejnë si burime ushqyese për ujërat nëntokësore/ujëmbledhës për furnizimin me ujë të bashkisë dhe të qyteteve përreth.

Fondi Pyjor e kullosor : Bashkisë së Kuçovës është rreth 4,777 ha dhe gjendet kryesisht në tre komunat e bashkisë që janë Kozare, Perondi dhe Lumas. Komuna Lumas dallohet për sipërfaqen më të madhe të këtij fondi me 340 ha e ndjekur nga Komuna Perondijne 333 ha dhe Kuzarë me 784 ha.
Mjedisi: bashkia dallohet edhe me **sfidat e ndotjes së ajrit** dhe të tokës nga industria e naftës dhe burimet të ujrat të cilat ndikojnë dhe në prodhimin e produkteve bujqësorë blegtorale. Dy nga ndotësit më të përhapur në qytetin e Kuçovës dhe në zonën përreth janë LNP-ja, e cila e ka origjinën nga autonjetet që lëvizin në zonë, dhe H2S e cila e ka origjinën nga industria nxjerrëse e naftës që operon në zonë. Ndërkohë, falë industrisë nxjerrëse të naftës, lëndë të ljeru ndotëse në ajër të cilat nuk janë mbi normat e lejuara janë edhe oksidet e squfurit, si tmjta SO2 dhe benzeni të cilat në të shumtën e rasteve janë mbi normat e lejuara, edhe i herë herë burim i shtuar sëmundje të ndryshkrive dhe ndotjes së mjedisit. Në këto kushte, Bashkia Kuçovë ka prioritet sëtimin e lupsitave të gjitha pranë industrive ndotëse, si dhe të bashkëpunojë me inspektoriatet shtetërore dhe vendore të mjedisit për kontrollin e vazhdueshëm të zbarimit të kushteve të lejeve mjedisore të bizneseve përpunuese të naftës.

Situata e punësimit në nivel njësie administrative dallon e diversifikuar për Kuçovën dhe mjaft e orientuar drejt sektorit bujqësor për Kozaren, Perondinë dhe Lumasin. Në Kuçovë, sektori kryesor me 40% të të punësuarve, janë shërbimet, ndjekur ngushtësisht nga industria (33.5%) dhe më pas tregtia. Sektori i ndërtimit dhe i bujqësisë së një pesë shumë të ulët (rreth 2% të të punësuarve). Nga njësitë e tjera administrative, Perondia ka një diversifikim disi më të madh, me sektorin e shërbimeve që zë 10% të punësimit. Edhe në Lumas, ky sektor që një peshë të madhe, 9.6%, në raport me sektorët e tregtisë, industrisë, etj. Gjithsesi në këto njësi, sektori bujqësor është dominues në vlerë 71-82%. Kuçova ka një normë 26.5% të papunësë së, përkundrejt normës mesatare kombëtare.

Gjendja e përgjithshme e strehimit në Bashki është problematike. Aktualisht, vetëm në qytetin e Kuçovës ka 865 familje të pastrehë, nga të cilat 526 jetojnë në banesa me bashkëpronësi dhe 212 në banesa individuale 87.
Ndërkaq, situata e aplikantëve për strehim social është si më poshtë.
3 familje në banesa në rrezik shembjeje
38 familje të shpërngulëtit nga dhe egjyptian
51 familje aplikante për banesa sociale me qera
56 familje të strehuara në banesa me prenësi te bashkisë, pjesë e skemës së qerasë së lehtësuar
43 familje që jetojnë në territorin e UPN
440 familje janë trajtuar me VKB si aplikantë për Programin e Banesës me Kosto të Ulët, nga të cilat 28 kanë marrë mbështetjen nga Banka.

Rrugët, në Bashkinë Kuçovë rezulton të kenë 314 km rrugë lineare gjithsej, duke përfshirë këtu rrugët arteriale, dërt të tëra peizazhistikë e bujqësore. Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kuçovë (2012), në qytetin e Kuçovës ka patur 2.4 km rrugë lineare. Pra, bashkia e sotme qëndron para sfidës për të rikonstruktuar, mirëmbajtur dhe mbështetur me shërbime një rrjet rrugor 90 herë më të gjatë se i mëparshmi.
Shpërndarja e rrugëve sipas kategorisë së Kodit Rrugor dhe gjatësisë respektive:
Kategoria e rrugës Gjatësi (km).

Bashkia Kuçovë

Rrugë inter-urbane/rurale kryesore 23
Rrugë inter-urbane/rurale dytësore 17
Rrugë urbane/rurale kryesore 4
Rrugë urbane/rurale dytësore 56
Rrugë lokale 154

Mbetjet Urbane;

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Kuçovë ofrohet nga sipërmarrje private, e cila bën grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në venddepozitimit e tyre që ndodhet përgjatë brigjeve të lumit Devoll, në Rrethi Tapi, në një largësi 5.5 km nga qyteti i Kuçovës. Ky venddepozitim funksionon që prej vitit 1987. Në këtë venddepozitim mbetjet shpesh herë ngelizen dhe mbulohen me dhé, por ai është plotësisht i papërshtatshëm, pasi toka në këtë zonë është shumë aluviomale dhe mbetjet e lëngshme toksike depërtojnë lehtësisht në shtresat e tokës, duke dëmtuar jo vetëm shtresat nëntokësore, por edhe ujrat nëntokësorë dhe vetë ujrat e lumit.

Shërbimi parësor:

Në bashkinë Kuçovë gjenden 20 institucione shëndetësore, nga të cilat 1 spital (në qytetin e Kuçovës), 6 qendra shëndetësore, 7 ambulanca konsultore, 3 shtëpi me dentare dhe 3 farmaci. Kërcohet të shtohet një qendër shëndetësore në njësinë Perondi dhe 2-3 qendra shëndetësore, pra ambulanca konsultore në njësitë Kuçovë, për të përmbushur standardet e kërkuara të sigurimit të shërbimit parësor.

Arsimi:një vështrim i përgjithshëm i objekteve arsimore sugjeron se përgjithësisht, gjendja e tyre është mesatare,me nevojë për rikonstruksion/përmirësim. 16 gjithë kopshtet kanë nevojë për pajisje mësimore dhe laboratorike, dhe në 50% të rasteve muga për në to është e paasfaltuar. Vetëm 60% e kopshteve janë të pajisura me terren sportive.

Sa i takon shkollave të mesme, gjesa më e madhe e tyre kanë akses të mirë, me rrugë të asfaltuar, janë identifikuar shkollat që janë në gjendje të përgjithshme të degraduar, të nevojë për rikonstruktim lërësor: Shkolla e Kozares, Zdravës dhe Sheë Kozares, Tapi. Asnjë nga objektet arsimore nuk ka laboratorë dhe të gjithë kanë nevojë për pajisje dhe mjete mësimore. Gjithsesi gjendja e shkollave të mesme është përgjithësisht e mirë, dhe aksesi në to bëhet me rrugë të asfaltuar. Edhe në këto objekte mungojnë tërësisht laboratorët dhe ka nevojë për mjete mësimore, por të gjitha sigurojnë terren sportiv dhe kanë kapacitete optimale e klasash, pa konsideruar alternativën e kryerjes së mësimit me dy turne.

Mbrojtja sociale:

Qarku Berat, renditet ndër qarqet me përqindjen më të madhe të varfërisë në vend (12,7%), krahasuar me qarqet fqinje të Elbasanit, Korçës, Gjirokastrës, etj.

Si rezultat i kushteve të jetesës në varfëri ekstreme, ose pjesërisht-ekstreme, pak më shumë se 347 familje përfitojnë ne bazë ekonomike nga buxheti i shtetit dhe rreth 65 familje nga fondet e Bashkisë.

Shërbimet sociale;

Në administrimin e bashkisë nuk ka qendra sociale për të moshuar, për komunitete të ndjeshme, apo probleme sociale specifike. Këto shërbime mbulohen pjesërisht nga prezenca e një qendre rinore, me bibliotekë të përshtatur, një qendre kulturore, një qendre kulturore fëmijësh, qendrës për familjet me nëtësi ndryshe ku frekuentohen 10-14 fëmijë si dhe ambienteve sportive në stadiumi dhe në mjediset e fushës së sportit "1 Maji", në qytetin e Kuçovës.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është përfshirjeni per tre vjet i planeve te shpenzimeve te buxhetit permes lidhjes se dhe leperdrejte te programeve me vepsimtaritë, objektivat dhe qellimet e politikes.

PBA eshte perpiluar si nje proces buxhetor shume vjecar, integruar, me baze te gjere dhe i orientuar nga performanca, qepse :

- "Integruar" sepse çdo qellim dhe objektiv e Strategjisë së zhvillimit Ekonomik si pjesë e Strategjisë së Zhvillimit Territorial është i integruar ne nje funksion te caktuar te Njesise Vendore.
  Ne kete buxhet jane integruar buxhetet nga te arkëruat e vetë, te ardhurat me fokusin e transfertes se pakushtezuar e të kushtëzuar dhe tranaferës specifike.
- "Me baze te gjere" sepse, perfshin shpërndarjen e burimeve per te gjitha funksionet në njesitë shpenzuese.
- "Orientuar nga performanca" sepse procesi orienton shpërndarjen e burimeve ne perputhje me objektivat dhe prioritetet e njesise vendore dhe fokuschet ne produkte te cilat kane impakt te drejtperdrejte ne realizimin e këtyre objektivave.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve për periudhën: 2020- 2022. **Viti i parë i PBA, bëhë buxheti vjetor për vitin 2020.**

2. Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA);

a. Krijimi i një ndjeshmërie të drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve, të shprehura në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë Kuçovë, dhe prioriteteve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion.

b. Zgjatur i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare).

Bashkia Kuçovë

c. Një panashkim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për tre periudhë kështjellore, për të gjithë programet e shpenzimeve.

d. Inkurajimi i efektivitetit, efiçencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe shkëmbimin e burimeve.

e. Forcimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.

3. Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA):

Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomiko-social, duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërinë rajonale të Bashkisë Kuçovë në sektorin industrial, bujqësor e turistik, si dhe krijimin e efekteve të jetesës për banorët.

Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale, për të përmirësuar aksesin në baskët kryesore të mjedit, dhe në itinerare turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të mobilitetit, transportit, dhe shërbimeve në ndihmë me infrastrukturën.

Objektivi strategjik 3: Menaxhimi i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, duke vlerësuar rolin bujqësore dhe elementet e forte natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integrimit me potencialet rajonale turistike.

Objektivi strategjik 4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me nivele jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, dhe nivel më të lartë aksesi në aspektin social-kulturor.

Të gjitha synohen të arrihen nëpërmjet:

a. Përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritjes së efiçencës së grumbullimit të fondeve buxhetore, që është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet themelore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.

b. Sigurimit të një menaxhimeje dhe përdorimi efektiv dhe efiçent të burimeve.

c. Një kuadri qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore, forcimi i vijës mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve të fondeve.

d. Përmirësimi i administrimit të taksave dhe financave në zbatim të plotë të legjislacionit dhe përgjegjësisë individuale e kolektive.

e. Rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së komunitetit në buxhetim dhe mbajtjen e llogarive.

4. Kush përfshihet në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA)

a. Administrata dhe sektori mbështetës i Bashkisë,
b. Ndërmarrjet e varësisë,
c. Institucionet e varësisë.

Referuar formave të Ligjit të RF Organik të Buxhetit, sa më sipër, do të quhen **Njësi Shpenzuese**.
Si një proces që përfshin Bashkinë dhe të gjitha institucionet në varësi të saj, PBA mbetet një sfidë për përmirësimin e planifikimit dhe përdorimin efektiv të burimeve në dispozicion.
Kështu, ede program i veçantë do të përfshijë të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij.

Shpenzimet përbëhen nga:

a. Shpenzimet administrative (paga, sigurime dhe shpenzimet operative të Njësive Shpenzuese),
b. Shpenzimet kapitale.

PBA është hartuar në përputhje me standartet bashkëkohore si dhe mbështetet në trajnimet e specialistave të financës, taksimit taksave, shërbimeve publike, të organizuara nga Ministria e Financës, Institutit i Trajnimit të Administratës Publike, USAID-it, DLDP, Ambasada Zvicerane, si dhe mbështetur në përvojën pozitive të njësive të tjera vendore.

PBA është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe shqetësimeve të drejtpërdrejta të komunitetit, të evidentuara :

- Gjatë punës sonë të përditshme në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.
- Nga takimet e Kryetarit të Bashkisë me qytetarë
- Nga shqetësimet e përcjella nga Koordinatorë Qytetar.
- Nga kërkesat dhe ankesat e qytetarëve adresuar drejtorive përkatëse.

Bashkia Kuçovë

- Dëgjesat publike.

Kërkesat dhe shpjegimet e marra nga banorët lidhen me :
-Zgjerimin dhe cilësinë e shërbimeve publike, kryesisht shtrimin e pastrimit.
-Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore.
-Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve.
-Mirëmbajtjen e kanaleve kullues e ujitëse.
-Shtimin e fondeve për mbështetjen e shtresave në nevojë.
-Kërkesë për strehim.

Kërkesat e mësipërme janë mbajtur në konsideratë gjatë përgatitjes së buxhetit, brenda mundësive financiare që lejojnë fondet në dispozicion

Përveç të ardhurave të veta paraqitet edhe aplikimi i projekteve për tu financuar nga donatore

KAPITULLI II

Profil financiar i Bashkisë 2020 - 2022

Në zbatim të ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr 9632 date 30/10/2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" të ndryshuar. Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8 date, 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 125 date, 20.12.2012 (i ndryshuar me UB nr. 92 dt. 23.04.2019) i ngritit **Grupi** për **Menaxhimin Strategjik** (GMS) dhe urdhër të brendshëm nr. 93, dt. 01.11.2016 për krijimin e EMP, i ndryshuar me UB nr. 93 dt. 24.04.2019 , VKB nr. 35 datë 31.05.2017 për krijimin e GISBI.

Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm është bazuar në dokumentat bazë :

- Planin e përgjithshëm vendor.
- Planin e Investimeve Kapitale (PIK).

Parashikimi i treguesve ekonomiko-financiare për periudhën 2020-2022 është bërë në kriteret e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 8 date 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 7, dt. 27.02.2019. " Për përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm Vendor", mbi Transfertën e Pakushtëzuar si dhe totalin e të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore e të ardhura të gjera.

Totali i të ardhurave të veta së bashku me transfertën e kushtëzuar e të pakushtëzuar do të mbulojnë funksionet e veta të nofbashkëta e të delegjuara, të cilat i kushtojnë njësia e qeverisjes vendore.

Sipas udhëzimit të mësipërm dhe shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 909 prot., dt. 06.03.2019 :

- Nr. rasti 55 dt. të këtë funksione shtesë në të vitet e ardhshëm, do të këtë edhe shtesën të transferës së kushtëzuar.
- Niveli i transferës së pakushtëzuar të parashikuar në tre vitet e MPA-së :
  - Për vitin 2020 është parashikuar 167,783,249 lekë.
  - Për vitin 2021 është parashikuar 181,013,675 lekë.
  - Për vitin 2022 është parashikuar 192,159,667 lekë.

Treguesit me qëllim i kanë si prioritet strategjitë e Bashkisë me afat financiare dhe tendencat e buxhetimeve të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar nga situatat aktuale paraqitet një plan përfundimtar të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2020. **Sipas shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 20458 prot., dt. 11.12.2019 transfertu e pakushtëzuar dhe specifike për vitin 2020 do të jetë:**

- **Transfertë e pakushtëzuar: 161,955,000 lekë**
- **Transfertë e pakushtëzuar: 111,934,000 lekë.**

E ardhmja kushtëzohet gjithashtu edhe nga faktorë që nuk varen nga Bashkia, por nga Pushteti Qendror, si është rasti i ndryshimeve të politikave fiskale në nivel vendor, implementimi i politikave fiskale kombëtare me impakt lokal, transferimi i funksioneve të reja drejt pushtetit lokal etj.

Për këtë arsye parashikimet do të rishikohen çdo vit, për të reflektuar ndryshimet në politikat sektoriale të Bashkisë, reflektimet që pasqyrohen në **PLANIN E BUXHETIT** vjetor, të cilat do të miratohen, diskutohen dhe vendimohen në Këshillin Bashkiak.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar në potencialin e nivelit të gjenerimit të të ardhurave.

Parashikimi Afatmesëm i të ardhurave për vitet 2020-2022 është bazuar në realizimin e të ardhurave të viti 2018, për çdo taksë apo tarifë, si dhe në bazën e të dhënave që ekzistojnë në regjistrat e taksapaguesve të krijuar për çdo njësi administrative e në mënyrë të tillë që të kemi një plan të të ardhurave sa më afër realitetit, i cili paraqitet në tabelat në vijim.

Këto parashikime janë të lidhura ngushtë me një sërë faktorësh si :

- Gjendjen në të cilën ndodhet ekonomia e vendit tonë në tërësi si dhe ajo e njësitë tona në veçanti

Bashkia Kuçovë

- Trendin rritës në vitet e të ardhurave lokale
- Mosndryshim të legjislacionit lokal që është aktualisht në fuqi.
- Masat që do të merren nga administrata tatimore vendore dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë për zbatimin e Programit.
- Pritshmëria për të ardhmen.

Cfarë parashikojnë në këtë Program Buxhetor Afatmesëm :

- Ofrim cilësor të shërbimeve publike pastrim, ndriçim, gjelbërim etj.
- Funksionim normal dhe cilësor me ujë të pijshëm.
- Përmirësim të infrastrukturës në ambjentet mësimore.
- Mbështetje sociale për shtresat në nevojë, gra të divorcuara dhe fëmijët në rrug.
- Përmirësim i infrastrukturës rrugore.
- Investime në infrastrukturë.
- Mbështetje për familjet e pastrehë.
- Prioritizimin e nevojave për investime dhe sigurimit e burimeve të jera të financimit, përmes aplikimit me projekte rek dorazi të ndryshëm.

Planifikimi i shpenzimeve është mbështetur në këto specifika:
Planifikimi i shpenzimeve është kryer duke u bazuar në rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, prioritare për komunitetin si pastrim, ndriçim publik, gjelbërim, infrastrukturë e vazhdueshme publike, përmirësimi i infrastrukturës shkollore, mirëmbajtje dhe investime në infrastrukturën rrugore, kulturës e sportit etj, si dhe dhe zgjerimin e shërbimeve sipas mundësive financiare të institucionit.
Në mënyrë të veçantë mbetet prioritet i bashkisë gjetja e mundësive financiare alternative në përmirësimin e infrastrukturës sokollore.
Njësitë shpenzuese:
- Bashkia Kuçovë,
- Ndërmarrja Komunale,
- Qendra Ekonomike e Arsimit,
- Qendra Kulturore,

PLANI I TË ARDHURAVE TË VETA:

Në 000/ lekë

Nr	Emërtimi i të Ardhurave Tatimore Vitet	Faktë 2018	Faktë 2019	Plani 2020	P/Plani 2021	P/Plani 2022	P/Plani 2023
I.	Të ardhurat nga taksa	34274	51,909	64,492	64,492	64,492	64,492
1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël (Tatimi	2250	605	1,000	1,000	1,000	1,000
2	Taksa mbi Ndërtesat	5817	6,500	11,448	11,448	11,448	11,448
3	Taksa mbi tokën Bujqësore	6427	6,500	13,056	13,056	13,056	13,056
4	Taksa e fjetjes në hotel	427	131	200	200	200	200
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	3165	4,100	5,000	5,000	5,000	5,000
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (Legalizimet)	1869	1,150	2,000	2,000	2,000	2,000
7	Taksa mbi lejimin e të drejtës së pronësisë për automjetet e patundshme	127	9				
8	Taksa e regjistrimit të automjeteve	11174	12,314	10,000	10,000	10,000	10,000
9	Taksa për zënien e hapësirave publike	1220	300	1,215	205	205	205
10	Taksa e tabelës	419	200	418	418	418	418
11	Taksa e prokurimeve						
12	Taksa e zënies minerare	-	490	2,300	2,300	2300	2300
13	Taksa Truall						
II.	Të ardhurat Pasurore	4274	14,900	64,492	64492	64492	64492
1	Tarifa për pastrim	18506	29,500	31,692	31,692	31,692	31,692
2	Tarifa për hapësirat publike (Tregu Peng + Tarc ATL Mallit)	7084	7,509	8,200	8,200	8,200	8,200
3	Tarifa ujit të pijshëm						

Bashkia Kuçovë

4	Tarifa ndriçim rrugë	6981	9,995	10,629	10,629	10,629	10,629
5	Taksa Pallogrisë	269	350	320	320	320	320
6	Tarifa gjelbërimi	4,016	8717	7,685	7,685	7,685	7,685
7	Tarifa per Reklame		110	330	330	330	330
8	Tarifa pakum	289	270	300	300	300	300
9	Tarifa per ujesjellës e kanalizime	62	5				
10	Tarifa per shërbimet te tjera administrative (Leje ndërt. Vertetime, ..)	253		2,020	2,020	2,020	2,020
11	Tarifa per shërbimet Kopshte, Kulluse e varreza (Prevedijet)	82	570	2,580	2,330	2,330	2,330
12	Sporte dhe kultura						
13	Tarifa te tjera(Taksa Supervizi, Tarifa Arkivi, Taksa Pullës)	810	1650	1,280	1,280	1,280	1,280
14	Tarifa Jokale (Tarifa Pyjore)	190	140				
15	Tarifa e ndotjes mjedisit (Alhp)	31,575					
IV.							
1	Shitje Ndërtesa						
2	Shitje Tokë						
3	Shitje te produkteve te ndryshem						
4	Qera Tokë						
5	Qera nga Ndërtesat	63					
6	Interesa nga te ardhurat						
7	Qera nga Pasuritë Pyjore	2,382	2,950	12,328	12,328	12,328	12,328
8	Te ardhura nga ndermarrjet e ndryshme (Gurore objekte)						
V.							
1	Transfera e Pakushtezuar						
2	Grant I kushtezuar						
3	Donacione sponsorizime						
4	Te ardhura nga gjoba	2,001	1355				
5	Te ardhura te ndryshme nga vite fiskale						
6	Kapshtet e Qytetit	5,027	1,940	4,800	4,800	4,800	4,800
7	Te ndryshme (Sekuestrime, Debitore, Te tjera)	9,560	10577				
TOTAL		64,612	70,230	108,153	108,153	108,153	108,153

Te Ardhurat e Programuara per Buxhetin e Bashkise per vitin 2020 mbeshtetur ne ligjet dhe tarifat vendore te bazuara ne trajtesit baze te te ardhurave te planifikuara dhe realizuar gjate viteve 2018 e realizimi I pritshem 2019 per te gjitha Njesite Administrative; Kucove, Kozare, Peroadi dhe Lumas.

Baza ligjore mbi te cilin eshte mbeshteur hartimi I Programit I te Ardhurave per vitin 2020 ;

- Ligji Nr.9632 date 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" I ndryshuar,
- Ligji Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" , neni 35 , 36, 37.
- Ligji Nr.68/2017, date 27.04.2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore", kreu III "Te ardhurat e veta te vetëqeverisjes vendore", te parashikuara nga neni 19 deri neni 20,
- Vendimi I Keshillit Bashkiak, Nr ___ date 21.11.2019 "Mbi Miratimin e Taksave e Tarifave Vendore per vitin 2020"

Ne zbatim te legjislacionit te me sipërmë kemi ketu grupe te ardhurash:

I. Te ardhurat kalimore nga taksat dhe tarifat vendore si.

- taksa vendore mbi pasurite e luajtshme e te paluajtshme dhe transaksionet mbi to.
- taksa vendore mbi veprimtarine ekonomike te biznesit te vogel e te mesëm.
- taksa vendore mbi veprimtarite e sherbimeve individuale.
- taksa vendore te perkohshme e te tjera te percaktuara me ligj.

II. Te ardhurat jo-tatimore te cilat perbehen nga:

- te ardhurat nga tarifat per sherbimet e ndryshme
- te ardhurat nga shitja dhe dhenia me qera
- te ardhura te tjera.

TE ARDHURAT

Bashkia Kuçovë

Në analizën e treguesve të të ardhurave i referohemi vitit 2020 pasi edhe për të vitet e ardhshme parashikohet e njëjta vlerë, për faktin se janë marrë në konsideratë të gjitha buxhetet e mundshme, ndërkohë që fuqia e tarifave për shfrytëzuesit te kategoritë: Biznes I madh dhe ndërmarje e Institucione, kompensën mungesën e të ardhurave te prodhimi që vjen si rrjedhojë e migrimit apo emigrimit të popullsisë, programit "ambicioz"te mos-rritjes se tarifave per abonentet familjar.Te ardhurat e Bashkise jane programuar mbi bazen e realizimit te treguesve te te ardhurave ne vite si dhe ne baze regjistrave te krijuar per te gjithe grupet e subjekteve familjar, te ndermarjeve e institucioneve, biznesit te madh , biznesit te vogel te ngritur administrative dhe ato te Bashkise , duke e rritur cdo vit e faktorizuar per çdo vit, per te arketuar sa me shume te ardhura ne mbeshtetje te tille qe Bashkia te permbush misionin e saj te percaktuar ne ligjin nr. 139/2015 dt.17/12/2015 "Per Vetqeverisjen Vendore". Te ardhurat per vitet 2020-2022 jane parashikuar ne vleren 192 153 000 leke dhe sipas njesive administrative jane:

Njesia Administrative	Vlera/Leke	%
Kuçove	158 926 000	82.7
Kozare	10 817 000	5.6
Perondi	11 750 000	6.2
Lumas	6 657 000	3.5
Totali	192 153 000	100

Ndersa realizimi ne vite i te ardhurave paraqitet si me poshte:

Emertimi	Realizimi ne vitin 2017	Realizimi ne vitin 2018	Plani ne Vitin 2019	Realizimi gjysh 2019	Ne mije leke Plani ne Vitin 2020
Te ardhura gjithe	234 676	128 612	201 072	130,266	192 153

Prej sipe shohim dhe nga tabela e mesiperme se realizimi i pritshem i te ardhurave per vitin 2019, eshte po ne te njejtin trend, me vitin paraardhes, krahasuar me planin 2019 pasiqe e mosrealizimit e ze taksa e trazilli nga Baza Ushtrazake Ajrore. Niveli i taksave dhe tarifave është parashikuar sipas VKB nr. 93 date 23/11/2019 "Për Paketen Fiskale 2020"

A. TE ARDHURAT TATIMORE

1.TAKSA MBI BIZNESIN E VOGEL.

Te ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogel me (Jatine Fizike i Ekzistimit) , ne zbatim te Ligjit Nr. 9632 dt.30.10.2006, i ndryshuar ze nje perqindje fikse te vogel, per sakaq te ndryshimit te fere, ku subjektet e biznesit te vogel me xhiro nga 0-5 mln leke me vlerë te cilet zene mbi 90 % te numrit te pergjithshem te subjekteve te biznesit te vogel dhe paguajnë mesatarisht nga 25 000 leke deri ne 40 000 leke ne vit, edhe per vitin 2020 do te paguajne 0 leke/vit, kurse per subjektet me xhiro 5 deri 8 milion, shkalla tatimore e aplikueshme eshte e ulet, dhe keto subjekte do te paguajne tatimin, jo 7,5 % por 5 % mbi fitimin e ndjeshem.

Tatim fitimi i dijeshtuar per vitin 2020 parashikohet me nje kundrejt 2019 ne shumen proj - 500 000 leke, shkak i realizimit te ulshem per kete vit fiskal .

2. TAKSA MBI PASURINE

Te ardhurat e planifikuara nga kjo taksë ne zbatim te ligjit nr. 9632, dt..30.10.2006, i ndryshuar , neret 22 . 23 dhe 23/1 perbehen nga:

a.Taksa mbi ndertesat,
b.Taksa mbi token bujqesore,
c.Taksa mbi tokat.

a.Taksa mbi ndertesat,

Planifikimi i te ardhurave nga taksa mbi ndertesen bazohet ne sipërfaqen faktike te ndertesës ne metër katror me tarifat përkatese te miratuara ne Paketen Fiskale ne VKB nr. 93, date 23/11/2018:

- per cdo ndertese banimi per familjaret,
- per cdo ndertese ku ne te cilen ushtrohet aktivitet biznesi I madh dhe biznesi i vogel

Mbeshtetur dhe ne arkëtimet e viteve si dhe ne baze te regjistrave te krijuar per taksen e ndertesës ne bashki dhe njësitëadministrative planifikohen te ardhura si me poshte vijon:

Ne mije leke

Emertimi	Totali	Kuçove	Kozare	Perondi	Lumas
Ndermarje e Institucione	-	-	-	-	-
Familjaret	7 120	3 000	1 220	1700	1 200
Biznesi I Madh	975	790	65	120	
Biznesi i Vogel	3 443	1 787	370	636	650
Totali	11 448	5 577	1 965	2456	1 450

Bashkia Kuçovë

Ne zbatim te VKM-se nr 132 date 07.03.2018, si dhe ne zbatim te Vendimit te keshillit Bashkiak "Per percaktimin e Rregullave Kufizimese ne zbatim te e Agjentit Fiskal dhe faktojen e ekzekutimit te", Kryetari i Bashkise Kucove, ndihmuar nga Sherbimi Me Vjeshtellesin shka Berat ne rolin e Agjentit Fiskal me shtrirjen territoriale dhe sistemin kompjuterik te te dhenave, do te beje te mundur qe te kete Maksimalizim te arketimit nga kjo takse

1.Taksa mbi tokat bujqesore.

Te ardhurat nga kjo takse per vitin 2020 do te arkëtohet nga tre njesite vendore ne te cilat shtrihet siperfaqja e tokes bujqesore e ndare me ligjin nr. 7501 , dt.19/07/1991 me baze te regjistrave te krijuar duke u bazuar ne siperfaqen e tokes per cdo taksapagues si dhe ne vleren per cdo kategori te shprehur ne ligjin nr.9632 , date 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", te ndryshuar . Siperfaqja e tokes e ndare me ligjin nr. 7501 date 19/07/1991 ne te tre Njesite a dministrative mbi te cilen llogariten te ardhurat eshte 6122 Ha , e detajuar sipas Njesive eshte si me poshte.

Ne mije leke

Emertimi i Njesise	Numri i taksapaguesve	Sip.tokes bujqesore	Shuma Ne leke	Ne % Ndaj totalit
Njesia Kucove	2001	2230	4247	33.7
Njesia Perondi	2162	2383	5747	44.0
Njesia Qumas	1559	1799	2952	22.7
Totali	5724	6122	13056	100 %

Te ardhurat nga tatimi mbi tokat bujqesore programohen ne vleren 13 056 009 leke, te cilat zene 7 % te totalit te te ardhurave.

2.Taksa mbi Ujesjellsin.

Ne zbatim te Ligjit nr. 9632, dt 30.10.2006 te ndryshuar , taksa mbi Ujesjellsin (ja hapesire publike), per vitin 2020, eshte planifikuar me ekzekutime ne nje vlere 64 605 000 leke. Ne sferen e mungeses se vleres qe vinte nga Tarifa e Ndotjes (e cila nga ankimimet administrative dhe gjyqesore, u vertetua se nuk ka pasoshmeri ligjore), eshte programuar nje ekzekutue e vleres nga taksa e Ujesjellit, duke u pergatitur per argumentimin e data base per siperfaqet, vecanerisht per Albpetrolin si dhe strukturat e Ministrise Mbrojtjes ne territorin e bashkise Kucove dhe mundesimin e arketimit te vleres se programuar . Baza e taksen mbi ujesjellsin eshte siperfaqja e trualit e shprehur ne regjistrat e hartuar per cdo taksapagues, ne nivelet katror, ne proporsi apo perdorimit te taksapagesit e tarifuar me 0.02 leke/m² per familjaret dhe 18 leke m² per ndermarrjet dhe hizmeset, si me poshte vijon:

Taksa mbi ujesjellsin ne 000/leke

Emertimi	Totali	Kucove	Kozare	Perondi	Qumas
Ndermarje e Institucione	64 600	64 000			
Familjaret	400		55	220	125
Biznesi i Madh	139		26		
Biznesi i Vogel	61	21	40		
Totale	64 492	64 021	121	225	125

3.TAKSA E REGJISTRIMIT TE MJETEVE TE PERDORURA

Kjo takse, ne zbatim te Ligjit nr.9975 dt. 28.07.2008 "Per Taksat Kombetare", vilet nga strukturat e DPSHTRR-Berat dhe te ardhurat nga kjo takse derdhen ne favor te Bashkise ku ne zbatim te ketij ligji Bashkia perfiton 25 % te shumes se arketuar. Te Ardhurat e programuara nga kjo takse per vitin 2020, bazuar ne nivelin e arketimit te kesaj takse ne vitet 2018, 1 pritshmi 2019, do te jene ne masen 10 000 000 leke.

4.TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE

Te ardhurat nga taksa e ndikimit ne infrastrukture e cila perbehet nga Lejet per ndertimin e reja dhe legalizimet , do te realizohen ne zbatim te ligjit nr.9632 date 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", ndr 27, te ndryshuar me Ligjin 142/2015 date 17/12/2015 Ndertimi i aksit te rruges kombetare Kucove - Elbasan nuk realizoi te ardhura te pritshme, per ndertime ne lejen per ndertese, bazuar po ashtu dhe per mungesen prodhimi Mbeshtetur ne realizimin e viteve paraardhese, te pritshmit e vitit 2019, shqyrtimi ne bashkepunim me ASHK Kucove i kerkesave per legalizim menjehere te planifikojme rreth 5 000 000 leke per ndertimet e reja. Ndersa nga legalizimi i ndertimeve informale ne baze te zbatimit te procedurave te legalizimit planifikohen rreth. 2 000 000 leke.

5.TAKSE TARREJE

Te ardhura nga kjo takse per vitin 2020 ne zbatim te ligjit te miratuar nr. 142/2015, date 17.12.2015 ne te cilin theksohet se "per tabelat per qellime identifikimi, deri ne 2 metra katrore te trupezuara ne siperfaqen e ndertuese" , taksa e tabeles eshte 0 leke/vit, si dhe duke u bazuar edhe ne verifikimin konkret ne terren rezulton se per vitin 2019 jane arkeluar

Bashkia Kucove

dërrasë 158 765 leke dhe për vitin 2020 planifikojmë të arkëtojmë 418 600 leke, nga biznesi i madh e institucionet 250 000 leke dhe biznesi i vogël 168 000 leke.

B TE ARDHURAT NGA TARIFAT

1. TARIFA PËR ZENIEN E HAPËSIRËS PUBLIKE

Në zbatim të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, neni 32 të ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015,dt 17.12.2015, kjo tarifë, e cila me parë quhej "taksë" është përcaktuar që niveli i kësaj tarife për njësinë administrative Kuçovë të jetë 60 lekë/m²/muaj, kurse për njësitë e tjera administrative niveli i saj të jetë 30 lekë/m²/muaj dhe një kohë përfitimi me 8 muaj në vit në bazë të VKB nr. 41, datë 21.11.2019 "Pakeja Fiskale 2020".
Për vitin 2020, nga tarifa e zënies së hapësirës publike janë programuar të ardhura me vlerën 9 435 000 leke. Duke u bazuar në kërkesat që planifikojmë të lidhim me subjektet e biznesit të madh, të biznesit të vogël për zënien e hapësirës publike dhe gjurmën e saj brenda muajit Prill 2020, me tregues të përqendruar si dhe të ardhurat që na vijnë nga tregu i lirë, sipas njësive administrative janë planifikuar

Tarifa e zenies se hapesires publike — ne '000 Leke

Emertimi	Totali	Kuçove	Kosare	Perondi	Lumas
Biznesi i Madh	126	121	5		
Biznesi i Vogel	1 079	1 045	34		
Tregu i perqendruar	6 500	6 500			
Tregu i lire	1 730	1 450			250
Totali	9 435	9 116	39		250

2. TARIFA PËR THERRJEN E BAGETVE

Për vitin 2020 mbështetur në legjislacionin në fuqi, në arkëtimet e derdhanisëve dhe të pritshmit e vitit 2019, duke marrë në konsideratë që në territorin e bashkisë Kuçovë nuk funksionon asnjë therrore, nuk kemi programuar të ardhura nga kjo e gjithsesi mbetet që në rast të agrifjes dhe funksionimit të therroreve do të aplikohet tarifa ligjore për këto qëllim.

3. TARIFA PËR LEJET E TRANSPORTIT dhe PARKIMI

Këto të ardhura sigurohen nga njohja e Transportit Mall dhe Taksi të cilat paisen me Leje Transporti dhe Certifikata vjetore prane Drejtorise se Sherbimeve Publike ne Bashki Për vitin 2020 janë programuar 220 000 leke nga tarifa për leje transporti dhe 300 000 leke nga tarifa e parkimit.

4.TARIFA E PASTRIMIT

Për vitin 2020 të ardhurat nga kjo tarifë janë programuar 31 692 000 leke, në bazë të regjistrit të përfituesve të këtij shërbimi sipas grupimit të zonë në bashki dhe në njësitë administrative ku kryhet ky shërbim, në bazë të tarifave të miratuara me paketën fiskale për vitin 2020 për çdo grup përfitues dhe sipas njësive administrative janë planifikuar si më poshtë:

Ne mije leke

Emertimi	Totali	Kuçove	Kosare	Perondi	Lumas
Ndermarje e Institucione	8 731	8 731	0	0	0
Familjaret	10 841	7 951	990	1900	
Biznesi i Madh	4 439	3 919	140	350	
Biznesi i Vogel	7 711	6 051	570	780	300
Totali	31 692	26 652	1 700	3 030	300

Të ardhurat e programuara nga tarifa e shërbimit të pastrimit zënë 16.4 % të totalit të të ardhurave të programuara, këto të ardhura do të realizohen nga ngjentet fiskal të caktuar për secilën kategori ushtro-paguesish:
Tarifa e pastrimit për abonentët familjar njësia Kuçovë do të vazhdojnë të arkëtohen nga Agjenti fiskal Sh.A U.K Berat -Kuçovë për vitin 2019, ndërsa për subjektet e biznesit dhe ndërmarje&institucione nga Drejtoria e të Ardhurave; dhe abonentët familjar dhe subjektet e biznesit në njësitë administrative nga punonjësit e këtyre njësive.

Ndërsa numri i taksapaguesve përfitues të këtyre shërbimeve sipas njësive është si më poshtë vijon:

Emertimi	Totali	Kuçove	Kosare	Perondi	Lumas
Ndermarje e Institucione	23	23	0	0	0

Bashkia Kuçovë

Familjaret	8 644	5 663	1009	1979	0
Biznesi i Madh	83	64	5	14	0
Biznesi i Vogel	205	419	95	131	60
Totali	9233	5724	1109	2115	60

5 TARIFA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Per vitin 2020 te ardhurat nga kjo tarife jane programuar qe te jene 16 629 000 leke, ne baze te regjistrave te takse -pagueseve perfitues, dhe sipas njesive administrative jane planifikuar si me poshte:

Ne mije leke

Emertimi	Totali	Kopeve	Kozare	Desteshi	Lamas
Ndermarje e institucione	320	320			
Familjaret	7 142	6 195	391	736	0
Biznesi i Madh	574	512	16	46	0
Biznesi i Vogel	2 593	2 090	215	288	0
Totali	9 122	7520	532	1070	0

6. TARIFA PER MJEDISIN DHE GJELBERIMIN

Per vitin 2020 te ardhurat nga kjo tarife jane programuar 7 685 000 leke, ku kjo sherbim ofrohet vetem ne Njesine Kopeve ne baze te regjistrit te taksapaguesve sipas grupeve paragitet si me poshte:

Ne mije leke

Emertimi	Totali	Kopeve	Kozare	Prrondi	Lumas
Ndermarje e Institucione	2 210	2 210			
Familjaret	2 839	2 839			
Biznesi i Madh	1 591	1 591			
Biznesi i Vogel	1 045	1 045			
Totali	7 685	7 685			

Ne programimin e te ardhurave per vitin 2020, nje pesh te rendesishme zene dhe te ardhurat qe dote kalojnë nga prona e Bashkise ne shumen e 12 328 000 leke , si gerate nga dhenia ne pershirim e tokave bujqesore e pandrove nga ligji 7501, date 19/07/1991, ne 1428 ha, mandatimi i dhenies me qera te tokes pyjore ne 70 ha qe , si rezultat i pures se bere nga ana e Drejtorise se Bujqesise per kalimin e regjistrit te prones, saktesimin e tyre ne terren, hartimit te proceduave ligjore per shfrytezimin e aktakdit per dhenien me qera.

Po keshtu dhe nga hapesira lagjeve qe jep ligji nr. 68/2017, date 27/04/2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" , neni 14 "Tarifat vendore", germa ç, do te aplikohet nje tarifa e shtesmit per mirembajtjen e rrjetit te kullimit e vaditjes.
Ne buxhetin e te ardhurave per vitin 2020, krahas treguesve te analizuar me siper ne perberjen e tij do te jene dhe te ardherat qe vijne nga shtesimet qe kalkulojnë Bashkia nga kepshtet e qendrueshme te tjera sherbime.

Kosto e sherbimeve publike dhe mbulimi i kostos nga tarifat e konsumatoreve (perfituesve):

Nr.	Viti	Kosto e plote e sherbimit (000 leke)	Pjesa e Kostos që mbulohet Bashkise (000 leke)	Totali i tarifes se Mbledhur (000 leke)	Tarifa e mbledhur e Pastrimit në vite, sipas kategorive të përfituesve (000 leke)			Totali ne %	Pjesa e Kostos që mbulohet nga Tarifa e Pastrimit (në %)		
					Biznese	Familje	Institucione		Biznese	Familje	Institucione
1.Sherbimi i Pastrimit											
	2018	32 009	8 459	30 590	17 552	6 038	6 900	95.4%	54,8%	19.1%	21.5%
2.Sherbimi i Ndricimit Rrugor											
	2018	17 442	3 001	14 441	7 403	4 671	2 368	82.8%	42,4%	26,8%	13.6%
3.Sherbimi i Gjelberimit											
	2018	8 124	1 462	6 662	2 990	2 206	1 466	82.0%	36,8%	27.2%	18.0%

Bashkia Kuçovë

BUXHETI I VITIT 2020

BUXHETI I TË ARDHURAVE		524,565,865
I	*Të ardhurat e vetë*	192,153,000
II	*Transferte e pakushtëzuara*	163,959,000
III	*Transferte të specifikuara*	111,933,822
IV	*Transferte kushtesore*	39,752,758
V	*Të ardhura nga huatë*	18,377,285

në Lekë

Kod Qeverisje-Kod Institucioni	gr-til-kap	SHPENZIMET	TOTAL	6000	6010	6020-9	604	6060	609	231
		BASHKIA	306,152,685	96,861,084	15,704,743	91,496,158	2,421,785	1,796,000	1,350,000	98,522,916
124-2120501	00-01110	Planifikim Menaxhim Administrim	34,601,796	24,955,454	3,823,362	22,607,203	2,227,785		1,350,000	650,000
	00-01120	Qeshtje financiare dhe fiskale	15,296,555	13,118,437	2,079,886	200,000				
	00-01170	Gjendja civile	4,810,000	3,260,602	550,000					
	00-02340	Policia Hekurudhe	4,940,229	3,879,288	647,841	220,000				
	00-06200	Investime	10,228,950							10,228,950
	00-06210	Investime	24,936,601							24,936,601
	00-06410	Planifikimi dhe zhvillimi i territorit	8,277,606	5,264,454	1,405,152	108,000				
	00-06260	Sherbime publike vendore	19,633,191	10,640,591	1,806,979	7,185,622				
	00-03280	MNESH	14,531,600	11,105,000	1,880,000	1,200,000		346,600		
	00-04220	Sherbimet hugjsore, inspektrimi, ushqim	4,723,847	3,991,103	634,844	68,000				
	00-04260	Administrimi i Pyjeve	3,879,027	3,303,280	551,647	20,000				
	00-04240	Infrastruktura e Ujitjes dhe kullimit	17,849,534	3,372,380	629,587	9,447,167				1,000,000
	00-05030	Mjedisi	5,395,793	4,283,456	735,337	378,000				
	00-05100	Menaxhimi i mbetjeve	50,958,566			50,958,566				
	00-09230	Investime	29,971,693							29,971,693
	00-09130	Investime	31,783,077							31,783,077
	00-10410	Mbrojtja sociale	9,006,958	5,527,641	909,716	1,779,600		1,450,000		40,000
124-2124004	00-06260	Ndermarja Komunale	75,127,915	23,317,120	3,760,983	45,279,812	0	270,000	0	1,500,000
Miratimi i strukturës së punonjësve sjell përcaktimin më të qartë të roleve dhe detyrave të përgjithshme dhe specifike të organizimit të punës, marrëdhënieve ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike dhe paralele, duke përcaktuar dhe qartësuar më mirë kompetencat e çdo njësie të strukturës organizative, duke rritur cilësinë dhe efektivitetin e tyre, me qëllim që të rritet efiçenca e proceduravë që realizon institucioni në tërësi. Kjo strukturë i përgjigjet më mirë zhvillimeve të reja dhe kërkesave në rritje, për një shërbim në ndihmë të komunitetit në përputhje me standartet bashkëkohore.

Kjo strukturë e Bashkisë reflekton nevojat aktuale, ajo ndikon drejtpërsëdrejti në zbatimin e politikave përkatëse dhe të shërbimeve që ato realizojnë në praktikën e tyre të përditshme për përmbushjen e nevojave të komunitetit me të cilin ato operojnë.

Objektivat e politikës së programit:

a. Fuqizimi i kapaciteteve te burimeve njerezore ne Bashki ne menyre qe ti pergjigjen realizimit te vizionit per te ardhmerne qytetit.
b. Sigurimi i sherbimit cilesor dhe me etikë ndaj qytetareve.
c. Te ofrojë partneritet, koordinim dhe mirekuptim midis paleve duke garantuar mbarevajtje optimale te punes ne sherbim te komunitetit.
d. Krijimi dhe zhvillimi i nje mjedisi ekonomik, ne menyre te tille qe te jete sa me atraktiv dhe konkurues, i cili do te konsolidoje dhe garantoje qendrueshmerine ekonomike gjate periudhës afatmesme.
e. Promovimi dhe mbështetja e biznesit.
f. Permiresimi dhe zhvillimi i infrastruktures së nevojshme për rritjen e biznesit.
g. Gjetja e menyrave me efikase per zgjerimin e bazes se taksueshme te bizneseve dhe te familjeve.
h. Vleresim sa me real i detyrimeve te taksapaguesve nga ana e administrates tatimore vendore.
i. Ofrimi i nje sherbimi me cilesor dhe brenda nje kohe sa me te shkurter, ne saje edhe te informatizimit teresor te sistemit te taksave dhe tarifave vendore.
j. Asistence dhe keshillim nga administrata tatimore vendore per çdo biznes qe kryen aktivitet tregtar si dhe per çdo individ i cili deshiron te çele aktivitet te ri.
k. Administrim me efiçencë dhe efektititet i sistemit tatimor, përmirësim i infrastrukturës tregtare dhe ulje e informalitetit.
l. Krijimi i marrdhënieve të besimit reciprok midis Bashkisë dhe komunitetit.

Produktet që synohen të ofrohen:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit për qytetarët.
- Instalimi i sistemit të rrjeteve kompjuterike për administratën (permiresim i sistemit te IT).
- Rritja e produktivitetit të punonjësve duke zhvilluar dhe përdorur më mirë talentet, potencialin e tyre dhe kohën e punës.
- Sigurimi i programeve trajnuese që punonjësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë për të qënë më të kualifikuar për të realizuar detyrat që bëjnë aktualisht si dhe për të ecur përpara sipas kërkesave specifike të drejtorive përkatëse duke plotësuar nevojat për trajnime.
- Ne bashkëpunim me ASPA , sigurimi i programeve trajnuese që punonjësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë për të qënë më të kualifikuar për të realizuar detyrat që bëjnë aktualisht si dhe për të ecur përpara sipas kërkesave specifike të drejtorive përkatëse duke plotësuar nevojat për trajnime .
- Plotësim i vendeve vakante me nëpunës e punonjës, ne baze te politikave te percaktuara per rekrutim dhe legjislacionit ne fuqi.

Aktivitetet që synohen të realizohen:

➢ Transparencë e plotë e aktivitetit të bashkisë.

Bashkia Kuçovë

- Ofrim i shërbimeve ndaj qytetarëve në një kohë sa më të shpejtë.
- Kthim përgjigje dhe orientim i qytetarëve për zgjidhje, brenda afatit ligjor.
- Informim i publikut në lidhje me procesin e buxhetimit dhe llogaridhënies.
- Krijim dhe përditësim i bazës së të dhënave vendore.
- Plotësimi i kërkesave për kushte normale të punës në administrate. (Furnizim i vazhdueshëm me energji elektrike, ujë, kancelari, tonera për të gjitha drejtoritë e bashkisë, telefon internet, shërbime postare, shërbim pastrimi i përditshëm në ambjente të punës).

PER KESHILLTARET;

Shpenzimet për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, janë përcaktuar sipas ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore ..." i cili përcakton shpërblimin mujor të këshilltarëve në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë".
Shpërblimi për anëtarët e Këshillit Bashkiak do të jetë 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë. Bashkia mbështet 31 këshilltarë dhe 29 kryetarë fshatrash, për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësive ligjore.
Shpenzimet për shpërblimin e kryepleqve do të jenë në masën 7 % të pagës së Administratorit të Njësisë Vendore.

TRANSFERTA;

- Në zbatim ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore ...", neni 38 planifikojmë që Këshillit të Qarkut t'i transferohen nga të ardhurat e Bashkisë kuote anëtarësie 50, 000 lekë.
- Transferime agjentit tatimor Drejtorise Rajonale Tatimore për vjeljen e të ardhurave nga biznesi i vogël në masën 1% të shumës së arkëtuar.
- Transferime agjentit tatimor, U.K.B.K për arkëtimin e tarifave nga familjet në masën 2.5% të shumës së arkëtuar nga tarifat.

FONDI I KONTIGJENCËS:

Në bazë të ligjit nr. 9936, dt. 26.06.2008, " Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për këtë vit fondi i kontigjencës parashikohet **500,000 lekë**. Fondi i kontingjencës përdoret sipas përcaktimit në vendimin për buxhetin vjetor të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese.

FONDI REZERVË:

Në bazë të ligjit nr. 9936, dt. 26.06.2008, " Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për këtë vit fondi rezervë, parashikohet **500,000 lekë**.
Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen ose janë të pamjaftueshme të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Përdorimi i tij bëhet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

FONDI EMERGJENCËS: parashikohet në vlerën **350,000 lekë.**

Shpenzimet sipas programeve janë pasqyruar në dokumentin FPT.
Totali i shpenzimeve operative shkon në vlerën 21,589,822 lekë, ku pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet për pagesën e këshilltarëve e kryeplegve në vlerën 6,894,720 lekë dhe 6,310,102 lekë shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore. Në zërin shpënzime për të tjera materiale dhe shpenzime operative parashikohen shpenzime për regjistrimin e pronave, marrje të dokumentacionit nga zyra e Regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vnm, kthim pagese Kadri Xhemo etj.

-ÇËSHTJE FINANCIARE DHE FISKALE (01120):

Përshkrimi i Programit:
Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj.
Zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit;
Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.

Bashkia Kuçovë

Publikim i dokumenacionit dhe të dhenave të tjera për çështje dhe shërbime në funksion të zhvillimit të komunitetit.

Programi i zhvillimit ekonomik përpiqet të bëjë bashkërendimin e planeve dhe politikave buxhetore me nevojat ekonomike të Bashkise Kuçovë.

Ne themel te programit qendron angazhimi maksimal per sigurimin e burimeve financiare te mjaftueshme per funksionimin normal te Njesise se Qeverisjes Vendore.

Politika e Programit:

Politika e këtij programi konsiston në përmiresimin e funksionimit dhe menaxhimit te Bashkisë, në garantimin e përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë dhe transparencë të plotë për përdorimin e fondeve publike.

Krijimi dhe zhvillimi i nje mjedisi ekonomik, ne menyre te tille qe te jete sa me atraktiv dhe konkurues, i cili do te konsolidoje dhe garantoje qendrueshmerine ekonomike gjate periudhës afatmesme.

Objektivat:

- Promovimi dhe mbështetja e biznesit.
- Përmiresimi dhe zhvillimi i infrastruktures së nevojshme për rritjen e biznesit.
- Gjetja e menyrave me efikase per zgjerimin e bazes se taksueshme te bizneseve dhe te familjeve.
- Vleresim sa me real i detyrimeve te taksapaguesve nga ana e administrates tatimore vendore.
- Ofrimi i nje sherbimi me cilesor dhe brenda nje kohe sa me te shkurter, ne saje edhe te informatizimit teresor te sistemit te taksave dhe tarifave vendore.
- Asistence dhe keshillim nga administrata tatimore vendore per çdo biznes qe kryen aktivitet tregtar si dhe per cdo individ i cili deshiron te çelë aktivitet te ri.
- Administrim me efiçencë dhe efektititet i sistemit tatimor, përmirësim i infrastrukturës tregtare dhe ulje e informalitetit.
- Transparencë të plotë për përdorimin e fondeve publike.

Produktet që synohen të ofrohen:

Regjistër i bazës së të dhënave i përditësuar.
Informim në kohë reale i taksapaguesve për detyrimet.
Raporte periodike financiare të publikuara.
Familje në nevojë të lehtësuara nga barra fiskale.

3.SHËRBIMET TË POLICISË VENDORE (03140):

Përshkrimi i Programit:

Ky program konsiston në ruajtjen e rendit, qetësisë publike dhe mbrojtjen e pronës publike.

Objektivat:

1. Ruajtja e rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike në përputhje me dispozitat ligjore.
2. Të konstatojë, parandalojë dhe ndëshkojë ndotësit e mjedisit.
3. Parandalimi dhe marrja e masave për shmangien dhe prishjen e ndërtimeve të paligjshme dhe zënien e ndërtesave dhe objekteve të Bashkisë.
4. Marrja e masave për ruajtjen e rendit dhe qetësisë ku ka grumbullime njerëzish si në tregje, panaire, ceremoni publike, artistike, kulturore fetare, sportive, në kinema, teatro si dhe mjedise të tjera publike.
5. Të kujdeset për qetësinë publike, duke shmangur zëniet, mënjanuar zhurmat e shkaktuara nga grumbullimet e njerëzve, altoparlantëve që sjellin shqetësim për të tjerët.
6. Kontrolli i respektimit të orarit të shërbimit të njësive tregtare, bufeve e restoranteve lojrave të fatit dhe të objekteve të tjera.
7. Marrja e masave për ruajtjen e pasurisë së Bashkisë.
8. Marrja e masave për shoqërimin në institucionet përkatëse të të sëmurëve me problem mendore, që krijojne shqetësim për rendin publik.
9. Të sigurojë zbatimin e akteve administrative të nxjerra nga kryetari i bashkisë në lidhje me personat fizikë e juridikë që nuk plotësojne konform ligjit detyrimet financiare e fiskale ndaj Bashkisë.

4.MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE (03280):

Pershkrimi i Programit

Ky program konsiston ne ruajtjen e jetës së komunitetit dhe të pronës publike e private. Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;
Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;
Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;
Mbrojtjà Civile,dhe administrim i strukturave përkatëse; shërbimet e mbrojtjes civile.

Objektivat:

1-Marrja e masave parandaluese për mbrojtjen e jetës së komunitetit dhe të pronës.
2-Forcimi i gatishmërisë së efektivit dhe të mjeteve në dispozicion
3-Rritja e aftësive tekniko fizike e profesionale të efektivit.
4-Përmirësimi i infrastrukturës së Stacionit të M.Z.SH-së.

Produktet që synohen të ofrohen;

Ruajtje e jetës dhe e pronës private e publike.
Shërbim i ofruar në kohën më të shpejtë të mundshme.
Parashikimi i fondeve për këtë program është bërë bazuar në kërkesat konkrete të kësaj strukture.
Parashikimi i transfertës specifike është si në vitin 2019. Financimi i shpenzimeve të miratuara me vkb nr. 12 dt.10.03.2015 do të bëhet me fondet e veta të Bashkisë dhe është parashikuar në këtë program buxhetor.

5.SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI, USHQIMI DHE MBROJTJA E KONSUMATOREVE (04220):

Përshkrimi i Programit

Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave;
Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistikapër çështjet dhe shërbimet bujqësore;
Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve;
Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë;
Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural.
Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit.

Objektivat:

1.Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave
2.Prodhimi dhe përhapja e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet bujqësore
3.Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinare për blegtorinë

Produktet që synohen të ofrohen

Regjistër i bazës së të dhënave i përditësuar.
Raporte kontrolli ushqimor dhe kundravajtje administrative.
Fermerë të informuar për grantet për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

6.PROGRAMI I MIREMBAJTJES SE INFRASTRUKTURES NE UJITJE DHE KULLIM(04240):

Përshkrimi i Programit

Ky program parashikon mirëmbajtjen e vazhdueshme të kanaleve kryesore, kanaleve te dyta me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin. Sistemet e ujitjes dhe të kullimit funksionojnë për të nxitur dhe mbrojtjur interesat e të gjithë fermerëve. Këto sisteme funksionojnë gjithashtu për të parandaluar erozionin dhe ndotjen, si dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Politika e Programit

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë, me qëllim që t'iu mundësojë fermerve ujitjen dhe kullim normal në çdo parcele toke, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit te kanaleve ujitse dhe kulluese.

Objektivat:

1. Përmirësimi i kushteve ne sistemin e kanaleve ujitëse në tre njësitë administrative.
2. Përmirësimi i kushteve ne sistemin e kanaleve kulluese në tre njësitë administrative.

Produktet që synohen të ofrohen

Bashkia Kuçovë

Kanale ujitëse e kulluese të mirëmbajtura.
Kushte të përshtatshme për rritjen e kulturave bujqësore.
Regjistër i bazës së të dhënave i përditësuar.

Më konkretisht projektet e programuara për t'u mirëmbajtur për vitin 2020 për Kullimin dhe Ujitjen janë:

- **Në Njësitë Administrative Perondi, Kozare, Lumas:**

Nr	Emri i kanalit kullues (sipas inventarit, Kollona)	Kanal i I (pare) ne km	Kanal i II (dyte) ne km	Volumi Kanale I (pare) Ne m3	Volumi Kanale II (dyte) Ne m3	Vlera e shpenzimit Ne leke	Sasia e naftes (litra)
1	Vlashuku	-	2km	-	4500	17850	1050
2	Havaleas	2km	2km	8400	4500	51510	3030
3	Gege	1km	2.5km	4200	5625	39100	2300
4	Ferras	-	1 km	-	2250	8840	520
5	Frasher	1km	2km	4200	4500	34510	2030
6	Salc-Kozare	1km	4km	4200	9000	52700	3100
7	**Demollar**	-	2km	-	4500	17850	1050
8	Fshati Magjate	-	3km	-	7750	30940	1820
9	Fshati Perondi	3km	5.5km	12600	12375	99790	5870
10	Fshati Tapi	3 km	5km	12600	11250	95370	5610
11	Rreth Tapi	-	2km	-	4500	17850	1050
12	**Lumas**	-	1km	-	2250	8840	520
13	Vodez	-	-	-	-	-	-
14	Bardhaj -Sheqez	-	1km	-	2250	8840	520
15	Pastrim rrugesh	-	-	-	-	26010	1530
16	**Total**	**11**	**33km**	**46200**	**75250**	**51000**	**30000**

Për tre vitet e ardhshme parashikohen të njëjtat volume punimesh.

7.ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE (04260):

Në zbatim të ligjit nr 48/2018 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar, të VKM nr. 433 datë 08.06.2016 " Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit të ish Komunave /Bashkive", në Bashkinëe Kuçovë janë transferuar 4,707 ha pyje dhe kullota sipas listës së inventarit, e cila është verifikuar dhe janë bërë korrigjimet përkatëse bazuar në dokumentacionin përkatës. Në bashkëpunim me Shoqatën e Përdoruesve të Pyjeve dhe kullotave "Pylli i Blirit" fshati Frashër, Njësia Administrative Kozare me mbështetjen e Projekteve Mjedisore pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të financuar nga Banka Botërore, Qeveria Suedeze dhe Organizata Globale e Mjedisit kemi hartuar dokumentacionin për aplikim pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural duke e shoqëruar me projekt propozim për financim të punimeve për përmirësim pyjesh në një sipërfaqe prej 60 ha pyje të llojit lis. Projektet e paraqitura dhe masat e propozuara janë në përputhje me Planin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave Komunale.

Pershkrimi i Programit:

1.Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore. Ruajtje, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore.
2.Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e licencave për prerje drurësh.

Bashkia Kuçovë

3.Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e insekteve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë;
4.Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;

Objektivat e Programit:

Monitorim periodik i fondit pyjor, për mbrojtjen e pyjeve nga veprimtari të paligjshme si prerje, zaptime, gjueti etj.
Evidentim dhe ndëshkim i rasteve të kundravajtjeve administrative.
Grante, ose financime për të mbështetur rritjn e fondit pyjor.

Produktet që synohen të ofrohen:

Komunitet i ndërgjegjësuar për mbrojtjen e fondit pyjor.
Zgjerim i fondit pyjor.
Ndëshkim i rasteve abuzive.

8.RRJETI RRUGOR (04520):

Njësi Shpenzuese;
Ndërmarrja Komunale

Pershkrimi i Programit

Ky program parashikon mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, trotuareve, segmenteve rrugore, rrugëve rurale, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin në të gjitha njësitë administrative.

Politika e Programit

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin, me qëllim që t'iu mundësojë banorëve dhe mjeteve qarkullim normal, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar.

Objektivat e Programit

Te realizojme mirembajtjen e rrugeve ne masen 70-80% te mirembajtura mire dhe shume mire.
Permiresimin e rrjetit ekzistues te rrugeve te asfaltuara, të shtrirë në të gjithë qytetin, që t'u mundësojë qytetarëve qarkullim normal të mjeteve dhe komoditet në ecjen e këmbësorëve.
Te mirëmbahen trotuaret ekzistuese dhe te shtohen siperfaqet e reja te tyre.

Produktet që synohen të ofrohen

Mirëmbajtja e Rrugëve dhe trotuareve.
Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me asfaltobeton, riparimi i gropave të krijuara dhe vendosje pusetash.
Do të ndërhyhet në disa akse rrugore, sipas nevojes:
Mirëmbajtje e rrugeve te paasfaltuara prej 204,013 m^2.
Mirëmbajtja e rrugeve te asfaltuara prej 501,792 m^2.
Mirëmbajtje siperfaqe trotuare prej 39,140 m^2.

9.MENAXHIMI I MBETJEVE (05100):
Shërbimi për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve urbane

- **SHËRBIMI I PASTRIMIT:**

Përshkrimi i Programit

Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve;
Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
Grante, ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve;
Pastrimi i rrugëve, parqeve etj. me qëllim përmirësimin e ambientit dhe uljen e ndotjes.

Politika e Programit:

Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve higjieno - sanitare dhe mjedisore brenda standardeve bashkëkohore, krijimit të një ambienti sa më të pastër në blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti, si dhe në ambientet ku qytetarët te shlodhen, apo kalojnë një pjesë të kohës së tyre (në institucione publike si kopshte, shkolla etj.)
Njësi Shpenzuese
Bashkia.

Objektivat e Programit:

Pastrimin e rrugëve dhe shesheve kryesore të qytetit për tu krijuar qytetarëve një ambient të pastër.
Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve urbane në pikat e vend-qëndrimeve të kontejnerëve dhe pikave statike çdo ditë për të krijuar ambiente sa më të pastra dhe uljen e ndotjes në maksimum në blloqet e banimit (lagjesh, pallatesh, e

Bashkia Kuçovë

institucione publike).
Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve inerte në pikat e vendgrumbullimeve dhe pikave statike çdo ditë për të eliminuar ndotjet në bllokqet e banimit si dhe në ruajtjen e infrastrukturës mjedisore.
Larja dhe lagia e rrugëve, në rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit për uljen e ndotjes mjedisore nga qarkullimi i makinave dhe punimet ndërtimore.
Përmirësimi i kushteve teknike në vend depozitimin e mbetjeve urbane për uljen e ndotjes së ambientit të qytetit.
Përmirësimi i kushteve teknike në dezinfektimin e pikave nevralgjike në qytet që shkaktojnë ndotje të ambientit dhe në institucionet publike (në vendstrehimet, kopshtet, shkollat, spitalet etj..).

Produktet që synohen të ofrohen:

Pastrimi i Rrugëve:

Pastrimi i rrugëve sipas skemës dhe zgjerimi i kësaj skeme në vitet në vazhdim sipas standardeve bashkëkohore duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj komunitetit si dhe uljen e ndotjes në mjedisin rrethues.

2. Mirëmbajtja e Ambienteve Publike;
Uljen e ndotjes në mjediset publike ku përfshihen bllokqet e pallateve dhe lagjeve të qytetit të cilat nuk janë të planifikuara në skemën e shërbimit ditor.

3. Grumbullim – transportim i mbetjeve urbane;
Largimi çdo ditë sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve urbane nga vendgrumbullimi i kontejnerëve dhe pikave statike.

4. Grumbullim – transportim i mbetjeve inerte (ndërtimore);
Largimi sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve inerte nga vendgrumbullimi i mbetjeve urbane dhe ambientet publike.
5. Larje dhe lagie e rrugëve;
Larjen e rrugëve për uljen e ndotjes dhe lagie të rrugëve kryesore gjatë sezonit Prill-Tetor sipas një grafiku të miratuar.

6. Deratizimi dhe Dezinfektimi;
Dezinfektimin, deratizimin, e ambienteve publike për të pasur një ambient sa më të shëndetshëm për komunitetin.

7. Mirëmbajtja e Vend-Depozitimit të mbetjeve urbane;
Kavaletimi i mbetjeve urbane në vend depozitime për krijimin e kushteve sa më të mira ambientale për mbrojtjen nga vetëndezja dhe zjarret e mundshme.

8. Mirëmbajtje e mjeteve që kryejnë pastrimin e qytetit;
Për një shërbim çdo ditë të ambienteve ku komuniteti ka në përdorim duhet dhe një gatishmëri sa më efektive e mjeteve që përdoren për largimin e tonelatave mbetje urbane dhe inerteve.

1. Sherbimi i pastrimit, grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave urbane:
Treguesit për 2020-2022:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
I.	**N.J.A. Qyteti Kuçovë + Lumas**		
1.	Fshirja me fshesë dore e rrugëve dhe shesheve	m^2	167 000
2.	Grumbullim e transportim të mbeturinave urbane në vend depozitim (për kontenier)	copë	280
3.	Shërbimi i pastrimit në EC-të publike të qytetit	"	4
4.	Lagie rrugë e sheshe me mjet teknologjik	m^2	73 000
5.	Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike e pikat e grumbullimit të mbeturinave	ditë	312
II.	**N.J.A. Kozare**		
1.	Grumbullim e transportim të mbeturinave urbane në vend depozitim (për kontenier)	copë	95
2.	Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike e pikat e grumbullimit të mbeturinave	ditë	104
III.	**N.J.A. Perondi**		
1.	Fshirja me fshesë dore e rrugëve dhe shesheve	m^2	29 800
2.	Grumbullim e transportim të mbeturinave urbane në vend depozitim (për kontenier)	copë	95
3.	Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike e pikat e grumbullimit të mbeturinave	ditë	104
4.	Larja e kontenierëve metalikë	copë	95

Bashkia Kuçovë

(Shërbimi i pastrimit, shtesë për vitin 2020):

Për sistemimin e mbetjeve urbane në vend depozitimin e tyre në Fermën "Partizani", rreth 4 km nga qyteti i Kuçovës.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
I.	**Materiale**				
1	Karburant (25 l/ditex312 d/vit)	litra	7 800	160	1 248 000
2	Lubrifikant (vaj motori e vaj hidraulik)	"	150	400	60 000
3	Veshmbathje	palë	2	5 000	10 000
4	Vegla pune (karoce, lopate,cfiurk etj.)	copë	4	500	2 000
5	Karoca dore	"	1	5 000	5 000
6	Antidodë (2x40 l/ditex312 d/vit)				24 960
	Shuma I				**1 349 960**
II.	**Mirëmbajtje e mjetit, Fadrom (skrep) me thikë - 1copë**				
1	Mirembajtje makineri (riparime, SHT1, SHT2 etj.)				80 000
2	Blerje pjesë nderimi (goma, pjesë xhenerike etj.)				130 000
	Shuma II				**210 000**
III.	**Fuqia punëtore, orë pune gjithsej:**				
1	Specialiste (1x174 ore/mx12m)	orë pune	2088	220	459 360
2	Punetore (1x174ore/mx12m)	"	2088	180	375 840
	Shuma				**835 200**
	Sigurime shoqërore 16,7%				139 478
	Shuma III				**974 678**
	Shuma (I+II+III)				**2 534 638**
	Shpenzime plotesuese 4%				101 385
	Shuma				**2 636 023**
	E ardhura neto 10%				263 602
	Shuma				2 899 625
	TVSH 20%				579 925
	Shuma Totale				3 479 550

Shpenzimet të detajuara (në lek):

Art	Emertimi	Fakt 2016	Fakt 2017	Plan 2018	Plan 2019	Plan 2020
05100	MENAXHIMI I MBETJEVE	18,440,321	29,119,104	63,173,544	59,281,400	50,958,566
6022009	Shërbimi i Pastrimit	18,440,321	24,280,736	38,665,521	32,939,403	32,939,403
6022009	Pastrimi fatura te papaguara		4,838,368	24,309,848	24,916,477	17,021,163
6027500	Vendime gjyqesore, permbarimore			198,175	1,425,520	998,000

Kontrata me nr. 619 dt. 13.02.2019 për shërbimin e pastrimit është 5- vjeçare. Vlera vjetore e kontratës është 29,459,853 lekë.

Ndërsa 3,479,550 lekë parashikohen për mirëmbajtjen e landfillit gjatë procesit të rehabilitimit të tij dhe mik janë pjesë përbërëse e kontratës.

Detyrimet e prapambetura në total janë 17,021,163 lekë.

Shpenzime gjyqësore 998,000 lekë.

10.MBROJTJA E MJEDISIT (05630):

Përshkrimi i programit:

Bashkia Kuçovë nepermjet ketij programi synon ruajtjen, mbrojtjen dhe permiresimin e standarteve mjedisore duke u mbeshtetur ne zhvillimin e qendrueshem urban te Bashkise Kuçove.

Bashkia Kuçovë

Gjithashtu synojme rritjen e kapaciteteve institucionale per trajtimin e çeshtjeve mjedisore ne nivel vendor. Prioritet mbetet rehabilitimi i zonave të nxehta mjedisore siç eshte vendepozitimi i mbetjeve urbane ,depozitimit te mbetjeve inerte ne ish zonen industriale si dhe krijimi i zonave ripariane e mbrojtëse për të dy lumenjtë kryesorë.

Objektivat e Programit;

- Hartimi i Strategjisë për Kompostim të Mbetjeve Organike.
- Përmirësimi të rësor i sistemit të kanalizimeve, duke ndarë ujërat e bardha nga të zeza në qytet, e duke siguruar mbulim me rrjet për gjithë Bashkinë,
- Rehabilitimi i sistemit të gropave septike në periferi te qytetit por edhe ne fshatrat që nuk kanë akses në rrjetin e kanalizimeve,
- Kryerja e një studimi të integruar për vlerësimin e ndotjes nga nafta në tokë, ajër, ujëra sipërfaqësore dhe Nëntokësore.
- Krijimin e brezit të gjelbërt / fashës së gjelbërt ose zonës ripariane (me 100-200 m gjerësi, sipas rastit të studiuar), përgjatë gjithë gjatësisë së lumit Devoll, Seman dhe Lapardha.
- Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të inerteve lumore në Osum e Devoll: Lumenjtë e Basenit të Semanit janë shfrytëzuar inertet në rrjedhën e mesme dhe të poshtme. Me qëllim mbrojtjen e lumit, ruajtjen e cilësisë së ujërave të tij dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave nëntokësore rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me Këshillin e Basenit Ujor të Semanit:
- Të ndalojë urgjentisht shfrytëzimin e inerteve lumore, kryesisht në fillimin e hyrjes së lumenjëve Devoll e Osum në territorin e Bashkisë dhe në lumin e Lapardhasë përgjatë aksit në NJA Lumas, ku është vënë re shfrytëzim intensiv i inerteve lumore.

  Arritja e këtyre objektivave do të konsistojë në masat e mëposhtme:

Masa për mbrojtjen e peizazhit, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura

- Përmirësimi i peizazhit në territorin e Bashkisë Kuçovë nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve të gjelbra
- Ripyllëzimi i zonave të shpyllëzuara dhe të degraduara nga shkaqe të ndryshme
- Ruajtja e diversitetit të specieve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë
- Bashkia te lobojë ose të ndërmarrë vetë nismën për inventarizimin e specieve dhe përditësimin e tij për territorin e bashkisë (në bashkëpunim me Ministrine e Mjedisit dhe institucionet të tjera vendore dhe qëndrore, AKM, ARM, AKZM, ARZM).
- Hartimi i Planit të Mbarështimit të Fondit Kullosor,
- Hartimi i Planit të Mbarështimit të Bimeve Medicinale dhe Aromatike,
- Bashkëpunimi me fermerët e zonës për mbarështimin dhe ruajtjen e biodiversitetit e specieve bujqësore dhe blektorale lokale dhe vendase të cilat janë cilësuar si të rrezikuara nga lista e specieve të rrezikuara në shkallë vendi (ne bashkëpunim me ministrine e Bujqësisë dhe Ministrinë e Mjedisit).
- Kontrolli i zbatimit të moratoriumit të ndalimit të gjuetisë dhe prerjeve të pyjeve
- Rehabilitimi mjedisor i fushës së grumbullimit të mbetjeve aktuale, e cila është jashtë standarteve të kërkuara. Venddepozitimi aktual i mbetjeve të ngurta urbane shkakton një sërë problemesh në mjedis, duke ulur cilësinë e elementeve përbërëse të tij, si toka, ajri, uji dhe si pasojë ndikime negative në biodiversitetin e zonës. Ky venddepozitim, duke qënë fare pranë shtratit të lumit vlerësohet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ujit të tij e, si rrjedhojë, në florën e faunën ujore.
- Te shikohet mundesia e perfshirjes se zones se Sinecit ne zone te mbrojtur.

Masa për përmirësimin e mbrojtjen e cilësisë së ajrit në Bashkinë Kuçovë.

Uljen e numrit të makinave në qarkullim nëpërmjet fuqizimit të transportit publik dhe nxitjes së transportit alternativë (siç është transporti me biçikleta), dhe uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane,

- Shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytet,
- Hartimin e planeve për uljen e shkarkimeve në ajër nga industria e rëndë.
- Planifikimin efiçent të territorit
- Bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse (AKM e ARM) për monitorimin e përditshëm të treguesve problematikë të ajrit (P_{M10}, NO_2 dhe Benzenin) deri në përmirësimin e cilësisë së ajrit sipas standarteve ligjore.
- Krijimin e stacioneve të përhershme të monitorimit ditor të cilësisë së ajrit në Qytetin e Kuçovës dhe në zonën naftënxjerrëse në Kozarë ku ka një përqëndrim të lartë pusesh. Për këtë lipset bashkëpunimi me autoritetet përgjegjëse (AKM e ARM, dhe Institutin e Shëndetit Publik). Kostoja e nje monitorimi te vetem 2 javor per parametrat mjedisor te cilesise se ajrit llogaritet dhe parashikohet ne 300.000 leke.

Bashkia Kuçovë

- Krijimi i stacioneve fikse të monitorimit ditor të cilësisë së ajrit në zona me aktivitet të lartë industrial si ajo e naftës.
- Në këtë mënyrë arrihet të kuptohet se cili është ndikimi i industrisë në shëndetin e banorëve të Qytetit të Kuçovës dhe Kozarës. Kjo kerkon investim ne drejtim te blerjes se monitoreve automatik dhe gjysem automatike qe kane nje kosto financiare fillimisht rreth 20 mije euro dhe çdo vit rreth 3 mije euro per mirembajtje te ketyre aparaturave (kryesisht nderrim filtrash).Gjithashtu kjo kerkon dhe kapacitete teknike njerezore (specialist profesionist).

Duke patur parasysh që në territorin e Bashkisë Kuçove veprojnë subjekte të industrisë së rëndë (kryesisht industria e nxjerrjes dhe perpunimit të naftës) të cilët shkarkojnë sasi relativisht të larta në ajër, rekomandohet që Bashkia:

- të marrë pjesë aktive në dhënien e Lejeve Mjedisore (në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse) të këtyre subjekteve,
- të ndërmarrë nisma të herëpashershme për kontrollin e zbatueshmërisë së kushteve të lejeve mjedisore (të llojit A, B dhe C) dhe të ligjit në tërësi.
- të bashkëpunojë me Inspektoriatin e Mjedisit për zbatimin e normave të shkarkimeve në ajër nga sektori i industrisë.
- Të marrë masa që gjatë ndërtimeve (pallateve në veçanti qe per fat te mire ne Kuçove nuk ka por eshte parashikuar ne planin e masave afategjate) në qytet, të merren masa mbrojtëse për ajrin (të përdoren rrjeta, spërkatje me ujë, etj.)

Të menaxhohen mbetjet sipas parimeve të mbrojtjes së mjedisit (duke shmangur dhe parandaluar djegien e tyre si dhe duke parashikuar kapjen e gazrave që lëshojnë mbetjet gjatë shpërbërjes së tyre në venddepozitimet e mbetjeve. Pra, nevojitet që venddepozitimet e mbetjeve të pajisen me sistemin e kapjes së gazrave që çlirohen nga degradimi i mbetjeve në mënyrë që të mos shkarkohen të pakontrolluara në atmosferë.

Edukimi mjedisor

Ne bashkepunim me rrjetet rinore te shkollave, organizatat jofitimprurese mjedisore dhe individ apo biznese te interesuar per mbrojtjen e mjedisit te pergatiten miniprojekte me karakter edukues dhe sensibilizues per mbrojten e mjedisit.

Shpenzime per studime mjedisore dhe monitorime.

- Krijimin e stacioneve të përhershme të monitorimit ditor të cilësisë së ajrit në Qytetin e Kuçovës dhe në zonën naftënxjerrëse në Kozarë ku ka një përqëndrim të lartë pusesh. Për këtë lipset bashkëpunimi me autoritetet përgjegjëse (AKM e ARM, dhe Institutin e Shëndetit Publik). **Kostoja e nje monitorimi te vetem 2 javor per parametrat mjedisor te cilesise se ajrit llogaritet ne 300.000 leke.**
- **Krijimi i stacioneve fikse të monitorimit** (do te ishte nje zgjidhje e perhereshme por qe ka nje kosto financiare te larte ne fillim te investimit),ditor të cilësisë së ajrit në zona me aktivitet të lartë industrial si ajo e naftës.

Shpenzime per edukimin mjedisor

- Miniprojekte me karakter edukues sipas kalendarit mjedisor.(Per diten boterore te mjedisit dhe diten e qyteteve pa makina.
- Pergatitja e flete palosjeve te ndryshme.

11.PLANIFIKIMI URBAN DHE STREHIMI: (06140)

Pershkrimi i Programit

Programi për planifikimin e territorit dhe investimeve synon implementimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për zhvillimin e territorit si dhe zbutjen e problemeve sociale në fushën e strehimit.
Qëllimi kryesor është: harmonizimi i zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë permes parimit te zhvillimit te qëndrueshëm të territorit.

Politika e programit

Në përmbushje të vizionit të bashkisë, janë hartuar objektiva strategjikë, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit në vitet e ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik.

Produktet që synohen të ofrohen

Bashkia Kuçovë

- Bashkia Kuçovë synon të monitorojë të gjithë territorin dhe të mos lejojë asnjë ndërtim të paligjshëm.
- Bashkia Kuçovë synon që të gjitha lejet e ndërtimit që do të jepen të jenë në përputhje të plotë me PPV.
-Bashkia Kuçovë synon të mbështesë kategoritë në nevojë me banesa sociale dhe rikonstruksion të banesave.
-Bashkia Kuçovë synon të mbështesë kategorinë e mëposhtme nëpërmjet bonusit të strehimit dhe banesave sociale që do të ketë në dispozicion.

Përparësi në përfitimin e bonusit të strehimit, me fondet e buxhetit të shtetit, kanë kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të nenit 24, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit", të ndryshuar, si më poshtë vijon:
a) Personat me statusin e jetimit;
b) Personat me aftësi të kufizuar, të cilët trajtohen në mbështetje të vendimit nr. 526, datë 6.8.2014, "Për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara që trajtohen me përparësi nga programet sociale të strehimit";
c) Familjet e policëve të rënë në detyrë;
ç) Familjet e komunitetit rom;
d) Emigrantët e riktheyer;
dh) Punëtori emigrant;
e) Punonjësit e Policisë së Shtetit

Gjatë vitit 2018 u ndërtuan 12 banesa sociale dhe u rikonstruktuan 26 njësi banimi të komunitetit Rom dhe Egjiptian, me vlerë 14,574,632 lekë. Gjatë vitit 2019 janë në proces rikonstruksioni 25 banesa të familjeve në nevojë.

12.1 SHERBIMET PUBLIKE VENDORE (GJELBËRIMI 06260) :

Njësia Shpenzuese:
Ndermarja Komunale
Sipërfaqja e gjelbër është rreth 10 ha. Çdo vit prodhohen mesatarisht 1,000 rrënjë ligustra. Aktualisht janë gjendje fidanë bliri 50 rrënjë, fidanë dafine 30 rrënjë, palma pëllëmbore 30 rrënjë, palma krehër 30 rrënjë, selvi 30 rrënjë, tuja 30 rrënjë.
Aktualisht në qytetin e Kuçovës janë rreth 2500 pemë dhe rreth 2500
Shkurre, ndërsa për tre ish komunat nuk kemi të dhëna statistikore. Shërbimet që u kryhen këtyre pemëve janë plehërim plotësues me nitrat, krasitje dimërore, trajtim kimik kundër sëmundjeve dhe dëmtimeve, ujitje etj.

Përshkrimi i Programit

Ky program konsiston ne mirëmbajtjen e siperfaqeve te gjelbra duke kryer te gjitha proceset teknologjike te punes per mirembajtjen e siperfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekorative, bordure te gjelber, mbjelljen e pemeve dekorative etj.
Shtim te siperfaqeve të gjelbra, duke synuar mobilimin e gjelber te çdo rruge, sheshi dhe shtimin e parqeve per femijet, si nje dekor edukues e atraktiv per qytetin dhe qytetaret.
Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme, në funksion të shërbimeve të përgjithshme publike.

Politika e Programit

Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve mjedisore për një ambjent sa me te kendshem dhe funksional, brenda standardeve bashkëkohore, krijimit të një ambienti shplodhes dhe qetesie ku qytetarët te kalojnë një pjesë të kohës së tyre, duke nderhyre edhe në blloqet e lagjeve dhe pallateve.

Objektivat e Programit

Mirembajtjen e siperfaqeve te gjelbra duke kryer te gjitha proceset teknologjike te punes per mirembajtjen e siperfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekorative, bordure te gjelber.
Shtimi i siperfaqeve te gjelbra duke shtuar mbjelljet me lule zezonale, sipërfaqe me bar, mbjellje e pemeve dekorative etj.
Rehabilitimi i sistemit te rrugicave dhe shesheve te pushimit ne parkun e qytetit.
Kompletimi me stola dhe tavolina për të krijuar vende shplodhje për qytetarët.

Produktet që synohen të ofrohen:

1. Mirëmbajtje e strukturës së gjelbër në bashkinë Kuçovë:

Kryerjen e të gjitha proceset teknologjike të punës si në një sipërfaqe prej 100,000 m^2, siperfaqe rruge dhe sheshe 9,000 m^2,
Sipërfaqe me bar dekorativ 1,000 m^2, sipërfaqe me lule sezonale 500 m^2, drure zbukurues rrugore 3,000 rrenje, gardh i gjelber 1,000 ml.

Bashkia Kuçovë

12.2 MIRËMBAJTJE E VARREZAVE PUBLIKE (06260),

Njësia Shpenzuese
Bashkia

Mirëmbajtje e sipërfaqeve dhe parcelave në varrezat publike, sipas volumeve të përcaktuara në preventivin e kontratës .
Nevoja per zgjerim dhe investim ne varrezat publike.

Qyteti Kucovë, Njesia Kozare, Lumas dhe Perondi. *Treguesit për 2020-2022*

Nr.	Analiza	Emertimi punimeve	Njesia	Sasia/vjetore	Çmimi	Shuma
1	An-1	Pastrim rruge e sheshe te betonit ne varreza.	m2	918,720	1.66	1,525,075
2	3.1	Prerje bari,kositje,pastrim e mirembajtje peme+shkurre.	m2	125,760	10.5	1,320,480
3	An-3	Riparim shtrese betoni,rruge dhe sheshe.	m2	530	403	213,590
4	2.291/1	Riparim bordura monolite 15x35	ml	20	751	15,020
5	An -5	Riparim muri rrethues me tulla	ml	5	3160	15,800
6	An -6	Riparim muri rrethues me bllloqe	ml	5	858	4,290
7	An -7	Riparim muri rrethues me gure	ml	2	2069	4,138
8	An -8	Riparim muri rrethues me rrjet gabion pa themelin	ml	60	1981	118,860
9	An -9	Riparim muri rrethues me rrjet gabion me themel	ml	6	3691	22,146
10	2.121	Riparim brezi (korniza) betoni mbi mur tulle,bllloqe , guri.	m3	1	12423	12,423
11	2.401	Lyerje me boje vaji te konstruksioneve metalike	m2	2	428	856
12	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gelqere	m2	80	44	3,520
13	2.390/1	Riparim konstruksione metalike,portave hyrje - dalje	m2	5	6803	29,015
14	An-14	Riparim qivuri,nga levizja e tokes	cope	5	2705	13,525
15	An-15	Zevendesim pllake mermeri e demtuar ne qivure	m2	8	7234	57,872
16	An-16	Zevendesim pllake graniti e demtuar ne qivure	m2	8	11126	89,008
17	An-17	Zevendesim pllake granili e demtuar ne qivure	m2	2	1258	2,516
18	An-18	N/Shtrese zhavorri 10 cm	m2	80	135	10,800
		Shuma e punimeve te drejteperdrejta				**3,458,934**
		Fondi Rezerve 5%				172,947
		Shuma				**3,631,881**
		TVSH-20%				726,376
		Shuma Totale				**4,358,257**

Për shërbimin e Mirëmbajtjes se varrezave publike në të katërta njësitë administrative Bashkia ka një kontratë 5 vjeçare, e cila është lidhur më dt. 11.05.2016. Vlera vjetore e kontratës është 4,358,237 lekë, po aq parashikohet dhe për tre vitet e ardhshme. Shpenzimet për këtë shërbim mbulohen nga fondet e bashkisë. Për këtë shërbim nuk është vendosur tarifë.

12.3 DEKORI (06260):

Përshkrimi i programit

Ky program përfshin mirëmbajtjen e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit, dukë kryer të Gjitha proceset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarrës dhe të këmbësorëve, tabelave rrugore etj. Mirëmbajtja e dekorit të qytetit, për festat zyrtare dhe sipas programeve të Bashkisë si dhe objekteve të artit si: lapidar, buste, skulptura.

Treguesit per 2020-2022 sipas kontratës së lidhur:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Qyteti Kuçove Vlera/lek
1.	F.V banderolash me dy faqe	cope	27	17 829	481 383
2.	F.V flamujsh per festa zyrtare	"	40	2 566	102 640
3.	F.V vijezim rruge per automjete	ml	2 000	252	504 000
4.	F.V vijezim rruge per kembesore	m^2	300	337	101 100
5.	F.V tabela te qarkullimit rrugor	cope	25	10 592	264 800
6.	F.V riparim lapidare e basoreliefe	"	6	20 000	120 000
	Shuma				**1 573 923**

Sherbimi i Dekorit (shtese per vitin 2020)

Bashkia Kuçovë

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera/lek
1.	F.V vijezim rruge per automjete	ml	1 000	252	252 000
2.	F.V vijezim rruge per kembesore	m^2	187	337	63 019
	Shuma				315 019

Shpenzimet për këtë shërbim mbulohen nga fondet e bashkisë. Për këtë shërbim nuk është vendosur tarifë.

13.NDRICIMI RRUGOR (06440):

Njësia Shpenzuese:
Ndermarja Komunale
Bashkia Kuçovë ka nën administrim një rrjetin rrugor të ndriçuar rreth 17.6 km. Numri i rrugëve me ndriçim është 41. Numri i shesheve me ndriçim është 8. Numri i shtyllave në total 665. Numri i shtyllave me ndriçim led 248, me ndriçim dekorativ 24. Numri i llampave 1,319, numri i llampave led 216 copë.

Përshkrimi i Programit

Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike;
Zhvillimi dhe rregullimi i standarteve të ndriçimit rrugor.

Politika e Programit

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin, me qëllim që t'iu mundësojë banorëve dhe mjeteve qarkullim normal, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar dhe zgjerim të sistemit te ndriçimit publik.

Objektivat e Programit

Krijimi i marrdhënieve të besimit reciprok midis Bashkisë dhe komunitetit.
Rritje e cilësisë dhe zgjerim i shërbimit.
Te mirembahet rrjeti ekzistues i ndiçimit publik dhe te mundesohet mbulimi i zonave te reja me ndriçim.
Programe menaxhimi dhe ekonomizimi të energjisë elektrike.
Programi 06440, ndriçimi rrugor menaxhohet nga Nd. Komunale.

14.SPORTI (08130):

Pershkrimi i programit

Masivizimin dhe konsolidimin e sistemit sportiv në dobi të shëndetit të shoqërisë sonë që nga fëmijët e kopshteve, të rinjtë, studentët dhe të rriturit.

Politika e Programit

Politika e këtij programi synon nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës sportive në qytet, nëpërmjet organizimit të projekteve sportive dhe pjesemarrjes ne aktivitete kombetare dhe nderkombetare.

Njësitë shpenzuese
Bashkia
Klubi shumesportit

Objektivat e politikes së programit

Rritja e cilësisë sportive të të rinjve pjesëmarrës në ekipe të llojeve të ndryshme të sportit, si shahut, ping - pongut, bilardos, basketbollit, boksit, karates, futbollit të ngritura pranë klubit te Shumsportit.
Arritja e sukseseve kombëtare dhe ndërkombëtare të ekipit të shahut për të tretin vit rradhazi kampion kombëtar si dhe sporteve te tjera.

Produktet që synohen të ofrohen;

-Vazhdimin e projekteve të Bashkisë për shtimin e hapsirave sportive, këndeve sportive, këndeve të lojrave brënda territoreve të banimit.
-Nxitja e aktiviteteve sportive të cilat ndikojnë në shëndetin e popullatës.
-Përmirësimin e infrastruktures sportive.
Për vitin 2020 shpenzimet pasqyrohen si në tabelat bashkëlidhur. Për shumë sportet parashikohen 400 mijë lekë dieta, nga të cilat 166,000 lekë dieta për shahun, 200,000 lekë dieta për volejbollin dhe 34,000 lekë dieta për bilardo.

Bashkia Kuçovë

15.ARTI DHE KULTURA (08220):

A. QENDRA KULTURORE

Përshkrimi i programit

Ky program përfshin tre sektorë: Qendrën Kulturore, Bibliotekën Publike dhe Qendrën Rinore.
Qëllimi kryesor i këtij programi është të ofrojë për komunitetin aktivitete kulturore me cilësi të lartë, shërbim korrekt dhe të shumllojshëm ndaj anëtarëve të bibliotekës, mbështetje për të rinjtë në realizimin e ideve që ata kanë.
Ky program synon t'i japë një hapesire me te plote jetes artistike dhe kulturore te qytetit jo vetem duke u mbeshtetur ne rivitalizmin e metejshem te projekteve ekzistuese, te cilat jane kthyer tashme ne nje tradite per qytetin tone, por edhe duke dhene hapesira te reja per projekte te tjera inovative te cilat vijne prane Qendres Kulturore e Bashkise nga persona te trete, shoqeria civile apo ente te tjera kombetare.
Ky program do të tentojë të promovojë vlerat kulturore të qytetit ç'ka do ta bente jo vetem për qytetarin e Kuçovës, por edhe vizituesin e tij, me atraktiv.

Politika e Programit:

Politika e këtj programi synon krijimin e një jete sa më të pasur kulturore dhe sociale për qytetin tonë duke përfshirë të gjitha grupmoshat dhe nivelet e ndryshme sociale dhe promovimin e një qyteti sa më tërheqës dhe konkurues për tregun e biznesit dhe të vizitorëve.

Njësi shpenzuese:

- **Qendra Kulturore**
- **Donatore**

Objektivat e politikes së programit:

- Ofrimi i projekteve artistike e kulturore inovative me nje cilesi te larte e bashkekohore.
- Perfshresimin e jetes sociale te qytetareve te tone nepermjet nderthurjes se projekteve tradicionale me angazhimin qytetar ne keto projekte.
- Prezantimi e promovimi i vlerave te qytetit per vizitorin e huaj.
- Forcimin e besimit tek qytetaret per nje qytet qe jetohet dhe qe te ben te jetosh.

Produktet që synohen të ofrohen:

1. Aktivitete te ndertuara, ne funksion te gjallerimit te jetes rinore dhe komunitare ne qytet. Kjo nepermjet hartimit dhe implementimit te nje programi me pjesmarrje.
2. Qendra Rinore si aktivitet ne funksion te te rinjve, ne qender te te cilit te jete rinia e sotme.
3. Kompletimi i ambjenteve te tjera te qendres kulturore me pajisje per te rritur efektivitetin e perdorimit te ketij aseti.
4. Java artistike per nxitjen e talenteve te reja.
5. Organizimi i konkurseve kulturore dhe historike për fëmijët e shkollave 9-vjeçare
6. Shtimi i pjesmarrjes se Qytetit ne konkurimet kombetare dhe me gjere ne funksion te ruajtjes dhe vitalizimit te tradites.
7. Mbështetje për projektet kulturore të rëndësishme që do të organizohen në qytet.
8. Rritja e cilësisë dhe numrit të aktiviteteve.

B. BIBLIOTEKA "FENIX":

Biblioteka ka në fondin e saj 12,691 ekzemplarë dhe 5,301 tituj.

Tregues të frekuentimit të bibliotekës:
Treguesit për 4-mujorin e dytë të vitit 2019, janë si më poshtë:

Aktualisht biblioteka ka në fondin e saj:
12.691 ekzemplarë 5301 tituj.
Sa i përket frekuentimit statistikat janë si më poshtë:
Total frekuentues: 8061
Anëtarë gjithësej: 1011
Përdorues të sallës: 168
Përdorues të internetit: 203

Objektivat e politikes së programit:

- Shtimi i fondit te librave për të gjithë grup moshat.
- Rritja e numrit te lexuesve dhe shumellojshmerise se librave te lexuara prej tyre.
- Promovimi i veprave dhe autoreve te ndryshem e kryesisht atyre vendas.
- Bashkepunimi me shkollat e mesme ne funksion te gjallerimit te jetes ne funksion te zhvillimit te aktiviteteve rinore per librin, poezine etj.

Produktet që synohen të ofrohen

1. Ruajtja e mirembajtja e fondit te bibliotekes ne numer dhe shtimi i tij duke e pasuruar me libra e materiale te tjera te nevojshme per te gjithe grup moshat.
2. Organizimi i aktiviteteve rinore qe nxisin kulturen e te lexuarit.

Kalendari vjetor i aktiviteteve per vitin 2020	
Aktivitete letrare dhe kulturore	**Koha e zhvillimit**
Dita e Veres	14 mars
Dita Nderkombetare e Poezise	21 mars
Dita Boterore e letersise per femije	2 Prill
Dita Boterore e letersise dhe te drejtes se autorit	23 Prill
Dita Nderkombetare e Muzikes	Qershor
Vera ne biblioteke	Qershor - Korrik
Kuçova summer fest	Gusht
Trashegimia Kulturore	Shtator
Sofra kuçovare	Tetor
Mozaik (aktivitet ne kuader te muajit te letersise)	Tetor
28 - 29 Nentor	Nentor
Koncerti i fundvitit	Dhjetor
Njeriu i Vitit	Dhjetor
Ekspozita te arteve pamore	Gjate vitit
Promovime librash dhe takime me shkrimtare	Gjate vitit
Dritare magjike (ne zbatim te politikave per nxitjen e leximit)	Gjate vitit
Pjesemarrje ne koncerte te ndryshme folklorike	Gjate vitit
Partneritete ne aktivitete te ndryshme artistiko - kulturore	Gjate vitit

C. QENDRA RINORE

Politika e Programit:

Politika e këtj programi synon krijimin e një jete sa më të pasur kulturore dhe sociale për qytetin tonë duke përfshirë kryesisht të rinjtë.

Në Qendrën Rinore realizohen aktivitete të ndryshme si dhe ofrohet shërbimi i bilbliotekës dhe internetit.
Mbledhja e bordit drejtues zhvillohet çdo muaj ku diskutohet mbi aktivitetet e muajit, planifikimin për muajin në vijim dhe angazhime të tjera jashtë Qendrës apo nga partnerë.
Në këtë qendër zhvillohen aktivitete ditore, të cilat realizohen ditën e hënë, të martë dhe të enjte.

Bashkia Kuçovë

Temat që diskutohen janë kryesisht sociale dhe jo vetëm, si: *Shkencëtarët: "Galaksia Jonë","Migracioni dhe Trafikimi i Qenieve Njerëzore", " Teknologjia në ndihmë të studentëve", " Dita e Tokës", "Dita e Europës ", etj...*
Klubi i kërcimit, klubi i pianos, klubi i anglishtes, klubi i Ping Pong-ut frekuentohen nga fëmijë të grupmoshave të ndryshme, në ditë të ndryshme të javës.
Qendra Rinore bashkëpunon me institucionet parashkollore dhe shkollore.
Do të jetë suport për përfaqësimin e qytetit në aktivitete të ndryshme jashtë tij.
Datat historike do të jenë në fokus për realizimin e aktiviteteve që përkujtojnë ngjarje të rëndësishme historike dhe kulturore.
Pasurimi i fondit të librave dhe promovimi i autorëve të ndryshëm do të jenë pika ku do të fokusohet puna në sektorin e bibliotekës.

Objektivat e politikes së programit:

- Ofrimi i projekteve artistike e kulturore inovative me nje cilesi te larte e bashkekohore.
- Permiresimin e jetes sociale te qytetareve te tone nepermjet nderthurjes se projekteve tradicionale me angazhi-min qytetar ne keto projekte.

Produktet që synohen të ofrohen;

1. Shtim i numrit të pjesëmarrëve.
2. Rritja e cilësisë së aktiviteteve.
3. Trajnime të të rinjve.

16.PROGRAMI I ARSIMIT BAZË DHE PARASHKOLLOR (09120)
17.ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM (09230)

Njësia Shpenzuese
Qendra Ekonomike e Arsimit:
Programi i arsimit është funksion i përbashkët. Shpenzimet për të mbulohen nga pushteti qendror dhe ai vendor.
Në territorin e Bashkisë Kuçovë ofrohen shërbime për:
Shkolla 9-vjeçare janë 16, shkolla vartëse nga kl.e I-V janë 11, shkolla të mesme 5, kopështe 25,
Numri i nxënësve në shkollat 9-vjeçare është 2,457,
Numri i nxënësve në shkollat e mesme është 860,
Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopështet është 717, për vitin mësimor 2019-2020.

Përshkrimi i programit

Programi i arsimit parauniversitar dhe edukimit parashikon veprimtarine ekonomike, financiare dhe ate te sherbimit ne mirembajtjen e kopshteve, çerdheve dhe shkollave 9-te vjeçare, te mesme te pergjithshme dhe profesionale qe jane brenda teritorrit dhe juridiksionit te Bashkise Kuçovë.

Politika e programit

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e kushteve optimale per mirerritjen e femijeve te moshes (0-3 vjec) per çerdhet dhe (3-6 vjeç) per kopshtet si dhe sigurimin e nje infrastrukture arsimore të përshtatshme per mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Objektivat e programit

Permbushjen me sukses e te gjitha detyrimeve ligjore ne fushen e arsimit.
Synimi i permbushjes se standardeve te miratuara nga M.A.SH ne Strategjine e Arsimit.
Permiresimin dhe rritjen e efektivitetit ne cilesine e sherbimeve ndaj institucioneve arsimore si dhe ne forcimin e kontrollit te fondeve te planifikuara ne buxhetin e arsimit.
Te realizoje mirembajtjen e kopshteve, çerdheve dhe shkollave te qytetit, duke synuar ne pembushjen e kushteve optimale, duke vleresuar si prioritet rikonstruksionin e tualeteve, oborreve, të shkollave e kopshteve dhe gjetjen e mundësive për financimin e projekteve për ndërtimin e shkollave (të vlerësuara të papërshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor) e kopshteve në njësitë Administrative Kozarë e Lumas.
Kompletimin e çerdheve me pajisje te reja, per shkak te amortizimit te pajisjeve ekzistuese.

Produktet që synohen të ofrohen:

1. Materiale zyre e te pergjithshme;

Ketu perfshihen te gjitha materialet per pastrim, deziinfektim, ngrohje e (gatim per nevojat e kopshteve, çerdheve) dhe shkollave.

2. Materiale dhe sherbime te tjera speciale;

Perfshihen te gjitha ato materiale si: uniforma dhe veshje speciale, ushqimet e femijeve, medikamente si dhe te tjera Materiale dhe sherbime speciale per nevojat e kopshteve, çerdheve dhe shkollave te qytetit.

3. Sherbime nga te trete;

Perfshihen te gjitha shpenzimet per energjine elektrike,uje dhe telefon, per te gjitha institucionet e arsimit parashkollor, 9-te vjecar, te mesem te pergjithshem e profesional.

4. Shpenzime transporti;

Perfshihen shpenzimet per transportin e ushqimeve te kopshteve e çerdheve.

5. Mirembajtje te zakonshme;

Perfshihen te gjitha materialet per mirembajtje te ndryshme, riparime e lyerjen e objekteve arsimore.
Shpenzime te tjera operative;
-Në permbledhësen e shpenzimeve programi 09120, perfshihen shpenzime për mirëmbajtje elektrike, hidraulike, vendosje të xhamave të thyer, lyerje dhe hidroizolime të objekteve Arsimore që kryhen nga Nd. Komunale.

18.ÇERDHE (10430)
Njësia Shpenzuese
Qendra Ekonomike e Arsimit:

Në bazë të numrit të femijëve që frekuentojnë çerdhet si dhe të udhëzimit Nr.1 date 02.05.1995 "Për normat e vendosjes së personelit në çerdhe", në buxhetin e vitit 2020, parashikohet pagesa për 23 punonjëse për pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Numri i fëmijeve në 3 çerdhe është 66, të ndarë 42 Meshkuj dhe 24 Femra.

Objektivat e programit

Mirembajtja e çerdheve, duke synuar ne pembushjen e kushteve optimale për ngrohje, ndriçim etj.
Pajisja e çerdheve me pajisje te reja, per shkak te amortizimit te pajisjeve ekzistuese.

Produktet që synohen të ofrohen:
Furnizime me ushqime cilësore, materiale pastrimi, ngrohje, energji, telefon dhe ujë, shërbime mirëmbajtjeje.
Ambjente të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.
Fondi i ushqimeve për fëmijet përballohet nga të ardhurat e marra nga kuotat që paguajnë çdo muaj prindërit e fëmijeve.

19. QENDRA DITORE PËR FËMIJËT ME AFTËSI NDRYSHE (10430):
Njësi shpenzuese
Qendra Ekonomike e Arsimit

Politika e programit

Rritja e sherbimeve dhe kualifikimi i punonjesve qe u sherbejne personave me aftësi ndryshe, klliente te qendrave.
Riaftësimi dhe integrimi në shoqëri i personave me aftësi ndryshe.

Financimi i këtij programi është pjesë e transfertës së kushtëzuar. Parashikohet shtimi i numrit të fëmijëve të kësaj qëndre për t'u gjendur më pranë nevojave edhe për tre Njësitë Administrative.
Aktualisht në qendër trajtohen 10-12 fëmijë.

Objektivat e programit

- Te ofroje nje mjedis te sigurt dhe te mbeshtese femijen qe te shprehin nevojat, deshirat dhe mendimet e tyre.
- Te punohet ne bashkepunim me prinderit dhe me personat e tjere qe ofrojne sherbime ne qender.

Bashkia Kuçovë

- Te hartoje programe individuale qe permbushin nevojat e cdo femije per tu zhvilluar, kjo ne bashkepunim me prinderit dhe personelin, me qellim qe te ofrohet nje mjedis i sigurt dhe mbeshtetes.
- Te ofroje sherbime te cilat ndihmojne ne zhvillimin e femijes ne te gjitha fushat.
- Te hartoje objektiva per zhvillimin e femijes te cilat do te sigurojne nderhyrjen ne fushen me emergjente te zhvillimit te femijes.
- Te organizoje aktivitete, te ofroje sherbime, te cilat respektojne moshen e femijes.

Sherbimet e ofruara per klientet kane per qellim riaflesimin psiko- socio-edukativ te standartizuar, per nje jetese te pavarur per personat me aftesi te kufizuar mendore e fizike.
Sherbimin ortofonik dhe logopedik qe synon permiresimin e komunikimit te klienteve
Sherbimi i fizioterapise per riaflesimin psiko-motor te klienteve me aftesi te kufizuar fizike.
Sherbimi administrativ nepermjet personelit ndihmes.

20.PROGRAMI I MBROJTJES SOCIALE (10430):

Pershkrimi i Programit

Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari;
Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të njëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare;
Ndihmë financiare assistance për pagesën e një kujdestareje që kujdeset për fëmijët gjatë ditës;
Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore.
Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigjenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktima të dhunës kriminale etj.);

Politika e programit

Trajtimi i familjeve ne nevoje me ndihme ekonomike, pagesa e paaftesise per personat me aftesi te kufizuar (me fonde te buxhetit te shtetit) si dhe trajtimin si "raste te veçanta", qe do te mundesojë vleresimin financiar te ketyre familjeve (me fondet e bashkise) duke kontribuar ne rritjen e te ardhurave te familjes apo nxitjen e punësimit.

Njësitë shpenzuese
Bashkia
(Buxheti i Shtetit)

Objektivat e programit

Reduktimi i varferise se familjeve ne nevoje.
Perfshirja ne skeme e individeve/grupeve te percaktuara me ligj
Perfshirja ne skeme si "Raste te veçanta" e individeve/grupeve te perjashtuara nga ligji.
Kalendari i aktiviteteve sociale:

Drejtoria e Sherbimeve Sociale ka parashikuar disa aktivitete te cilat korrespondojne me Ditet Nderkombetare te Sensibilizimit per grupe e ceshtje te ndryshme sociale si Dita Nderkombetare e Gruas, Dita Nderkombetare e Romeve, Dita Nderkombetare e Femijeve Jetime, Dita Nderkombetare e te Paafteve.

Parashikimi i shpenzimeve:

Art	Emertimi	Fakt 2016	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Plan 2020
10430	**KUJDESI SOCIAL FAMILJE DHE FEMIJE**	**1,404,826**	**1,774,435**	**1,173,790**	**8,317,416**	**8,317,416**
600	Paga				5,456,304	5,456,304
601	Sigurime Shoqërore				872,812	872,812
602	Mallra dhe sherbime					
6020100	Kancelari					

6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres				67,300	67,300
6029099	Njesia per mbrojtjen e femijeve				66,000	66,000
6029099	Barazia gjinore			0	220,000	220,000
6061001	Ndihme Ekonomike			0	185,000	185,000
6061003	Pagesa per femije ne risk,	1,404,826	1,774,435	1,173,790	1,200,000	1,200,000
	cerdhe+kopshte				250,000	250,000

Nga fondet e bashkisë gjatë vitit 2017 janë trajtuar çdo muaj, mesatarisht 65 familje me ndihmë sociale, në vlerën 1,800,000 Lekë. Për vitin 2018 Bashkia Kuçove ka trajtuar me fondet e saj 50 familje në nevojë me ndihmë ekonomike me fond 1,800,000 lekë. Familjet përfituese janë familje me problem social- ekonomike si: Gra të divorcuara, vajzë nënë, të vetmuara, persona me probleme shëndetësore etj.
Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në risk ka qënë në periudha të caktuara kohe.
NJMf. ka mbështetur për vitin 2018, 2 raste të fëmijeve nga familje në nevoje për pagesa në kopshte dhe çerdhe.
Për periudhën Janar – Gusht 2019, Bashkia Kuçovë ka trajtuar me fondet e saj 29 familje në nevojë me ndihmë ekonomike me fond 266,320 lekë. Familjet përfituese janë familje me probleme social- ekonomike si: Gra të divorcuara, vajzë nënë, të vetmuara, persona me probleme shëndetësore etj.
NJMf. ka mbështetur për vitin 2019, 3 raste të fëmijeve nga familje në nevoje për pagesa në kopshte dhe çerdhe.
Mbeshtetja do të jetë për një periudhë 6 mujore sipas vlerësimit të NJMF.

Edhe për tre vitet e ardhshme bashkia do të mbështesë familjet në nevojë me të njëjtat fonde.

- **Fondi i emergjences për rastet e dhunës në familje:**

Pershkrimi i programit

Qellimi i ketij nenprogrami konsiston ne ndergjegjesimin per problemet social-ekonomike te komunitetit e te shtresave ne nevoje qe do jene perfitues te projekteve, perfshirja e aktoreve te ndryshem lokale per te kontribuar ne zbutjen e problematikave te ndryshme, perfshirja ne keto aktivitete e veprimtarive kreative-argetuese.

Njësitë shpenzuese
Bashkia
Donatore

Politika e programit

Ky program synon te mbeshtese femije, familjet e te cileve ndodhen ne gjendje ekonomike te varferise ekstreme, femije te parregjistruar, endacake, te braktisur te cilet mund te perbejne kontigjent per fenomene te rrezikshme si trafikimi etj.
Keta femije dhe familjet e tyre (nese kane), do te mbeshteten me paketa ushqimore si dhe do te synohet tu plotesohen nevojat e emergjences per ushqim , veshmbathje qofte edhe per periudhen ne te cilen mund te strehoen ne qendra pritese.

Politika e programit

Ky program konsiston ne trajtimin e rasteve per femijet ne risk etj dhe te mundesoje venien ne rrugen e zgjidhjes te te gjithe problemeve qe hasen ne kete grup femijesh.

Objektivat e programit

Sensibilizimi permes botimit te broshurave, fletepalosjeve, materialeve ndergjegjesuese,
Trajnime, work-shop-e lidhur me çeshtje te te drejtave te gruas e femijeve,
Sensibilizim masiv permes njoftimeve/programeve televizive, banerave etj.
Mbeshtetje e aktivitetit te fundvitit per femijet jetime.
Integrimi i komunitetit rom ne shoqeri 2020 – 2022.

Mbeshtetja per femije me probleme te renda sociale, jetime e te braktisur.

Për NJMF, në tre vitet e ardhshme parashikohet fond (470 mijë lekë) për menaxhimin e rasteve si më poshtë:

Bashkia Kuçovë

Fond për Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve:	
1.1 Pagesa e qerdhe/kopshte për fëmijët në risk Ky fond do të shërbejë për të mbështetur rreth 10 fëmijë nga familje shumë në nevojë dhe me problematika sociale me pagesën e çerdhes/kopshtit. Me këtë nismë ne duam që të rrisim/fuqizojmë prindërit e tyre që të punojnë dhe të kenë një vend të sigurtë për të lënë fëmijët. Mbështetja do të jetë për një periudhë deri në 6 muaj, sipas vlerësimit të Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve për çdo rast.	150.000
1.2 Fond për organizimin e Kampit Veror Qëllimi i aktivitetit është argëtimi i 40 fëmijëvë, ndërgjegjësimi për institucionet që mbrojnë fëmijët dhe mbajtja larg e fëmijëve nga probleme të ndryshme sociale.	50.000
1.3 Fond për blerje librash për fëmijët në nevojë Për disa familje në nevojë/rrezik është e pamundur blerja e librave për fëmijët e tyre në fillim të vitit shkollor. Për të parandaluar braktisjen e shkollës ne kërkojmë këtë fond për të mbështetur rreth 10-15 fëmijë me blerjen e librave.	100.000
1.4 Menaxhimin e rasteve nëpermjet shërbimeve konkrete si: Pagesa në shërbime shëndetsore Shërbime gjyqësore Sigurimin e një strehe të sigurt të fëmijëve (pagesë qeraje) pa kujdes prindëror apo viktimë të dhunës dhe abuzimit në familje.	 50 000 50 000 60.000
1.5 Aktivitete Sensibilizuese ne komunitet për Ndërgjegjësimin e Fëmijëve mbi të drejtat e tyre.	10 000

- **Barazia Gjinore**

Njësitë shpenzuese
Bashkia

Pershkrimi i Programit

Ne zbatim te VKM Nr 334 dt 17.02.2011 specialisti i sherbimeve sociale , Bashkia ngarkohet me detyren e koordinatorit vendor per referimin e rasteve te dhunes ne familje. Nder detyrat dhe pergjegjesite e koordinatorit vendor eshte edhe asistimi i viktimave te dhunes ne familje per njohjen e te drejtave te tyre, ndjekja e te gjitha procedurave per marrjen e urdhrave te mbrojtjes , organizimi i takimeve per menaxhimin e rasteve, ndermjetesimi per sigurimin e nevojave te emergjences (nevoja psikologjike, keshillim, sherbime mjekesore, juridike falas, strehim etj) si dhe sigurimi i gjithe informacionit dhe dokumentacionit te nevojsh-em rast pas rasti.

Politika e programit

Politika e ketij programi konsiston ne mbeshtetjen dhe asistimin e njesise se qeverisjes vendore, nepermjet koordinatorit vendor, ne trajtimin e rasteve te dhunes ne familje.

Objektivat e programit

Sensibilizimi permes botimit te broshurave, fletepalosjeve, materialeve ndergjegjesuese.
Trajnime, eqmk-shope lidhur me ceshtje te te drejtave te gruas.
Sensibilizim masiv permes njoftimeve/programeve televizive, banerave etj.

Produktet që synohen të ofrohen

Permbushje dokumentacionesh (noterime,prokura,nxjerrje certifikatash etj) ne rast se do te paraqitet nevoja.
Pagesa e vleres se transportit ne rast se do te jete e nevojshme qe te referohet rasti ne strehezen jashte qytetit.
Akomodime 24 ose 48-oreshe sipas rastit te personave te rrezikuar (gra te dhunuara)deri ne dergimin e tyre ne qendra te specializuara .
Permbushja e nevojave me urgjente jetesore (ushqim,veshmbathje etj).

- Fondi i parashikuar per t'u perdorur ne vitet 2020, 2021, 2022 është **185 000 leke/vit** :

Bashkia Kuçovë

Parashikimi i fondeve për raste te dhunes ne familje do te perqendrohet ne keto zera:

- Pagesa e transportit ne rast se do te jete e nevojshme te referohet rasti ne streheza jashte qytetit (aktualisht bashkia nuk disponon streheza strehimi per raste te vecanta). Sipas raportimeve ne vit jane referuar rreth 22 raste, nese do kishim nje parashikim per gjate nje viti 8 raste te tilla duke i menduar nje shpenzime transporti rreth 5 mije leke, fondi i nje viti **40 000 leke.**
- Akomodime 24 ore ose 48 ore, sipas rastit te personave te rrezikuar deri ne dergimin e tyre ne qendra te specializuara, mund te parashikohen rreth 12 persona , per fjetje duke menduar per nje shpenzim 2000 leke/ nata per 12 persona ne vit parashikohet **24 000 leke.**
- Per nevoja emergjente jetesore ushqim, veshmbathje, dhe sherbime te tjera 10 persona duke llogaritur 1 mije leke dita **10 000 leke.**
- Per sherbime mjeksore nese do te duhet te shpenzohet per medikamente , apo vizita parashikohet nje fond me i larte pasi këto shpenzime jane me te medha, per 12 persona per cdo shpenzim mund te parashikohet nje fond 3 mije leke per nje person per gjate gjithe vitit **36 000 leke.**
- Mbeshtetur ne kalendarin e aktiviteteve sociale ne te gjitha ditet e shenuara qe kane te bejne me dhunen , trafikimin, barazine gjinore parashikohen qe te shperndahen paketa ushqimore per 30 raste ne vit nje fond prej 2 mije e peseqind leke per individ parashikohet **75 000 leke.**

Gjatë vitit 2020 parashikohet të zbatohet projekti " Krijim/ngritja e mekanizmit të reagimit të koordinuar(MRK) për adresimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familjë në Bashkinë Kuçovë " në programin 10430.Vlera e projektit është 984, 300 lekë, nga të cilat 781,300 lekë do të financohen nga UNDPI. Parashikohen 241,800 lekë për mjete të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve (kancelari), vlera 499,500 lekë parashikohen si kosto e trajnimeve, 40,000 lekë për pajisje zyre dhe pjesa tjetër e shpenzimeve parashikohet për energji, një shpenzime komunikimi etj.

Transferta e Kushtëzuar:

Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njësive vendore, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitë vendore. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë:

-**Shërbimi i gjendjes civile** si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime bëhen nga komunat dhe bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve më të detajuara që bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Brendshme.

-**Mbrojtja sociale,** si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministria e Mirëqënies – Sociale dhe Rinisë detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi te qeverisjes vendore, ne mënyre specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë.

Kapitulli IV: ALOKIMI I FONDEVE BUXHETORE (FPT):

PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE:

Në kuadër të reformës së re territoriale Bashkia Kucovë është rritur në territor me tre njësi të reja administrative (Perondi, Kozare, Lumas) duke arritur një sipërfaqe prej 160.22 km2 dhe numëron rreth 55 170 banorë.
Vizioni ynë është që ta kthejmë Bashkinë Kuçovë, në një nga zonat atraktive ekonomike dhe turistike të vendit, bazuar në burimet dhe potencialet natyrore që ka gjithë territori i ri në bujqësi, turizëm natyror dhe kulturor, burimet hidrike etj.

Ne dëshirojmë që të krijojmë një perspektivë të re zhvillimi për punesim, mirëqënie, duke shfrytëzuar çdo potencial inovativ dhe zhvillimor, me qëllim krijimin e një të ardhme me të sigurtë për brezat që do te vijnë.
Qëllimi kryesor është jo vetëm zhvillimi ekonomik i Bashkisë Kucovë, por edhe ulja e pabarazive sociale në zona të ndryshme.

Ne do te punojmë fort për nxitjen e investimeve infrastrukturore përmes programeve të mbështetjes, fuqizimin e Potencialeve turistike dhe bujqësore, përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e rajonit, zhvillimin e profesio-
-neve tipike rajonale për të rinjtë, bazuar në modele te inovacionit dhe modernizimin e sherbimeve dhe rritjen e efikasitetit per çdo njesi administrative.

Bashkia Kuçovë, me synimin madhor për një zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, ekonomik dhe mjedisor të territorit të saj do të mbështesë ekonominë lokale për të rimëkëmbur aktivitetin dhe ndërveprimin e shoqërisë për të mirën e

Bashkia Kuçovë

përbashkët.

Ky zhvillim do të arrihet duke mbrojtur burimet natyrore, sidomos ato me rëndësi kombëtare, hapësirat publike dhe kulturën e traditën vendore të kësaj zone, me qëllimin kryesor për një të ardhme sa më të qëndrueshme edhe për brezat e ardhshëm.

Bashkia e Kuçovës e ndërton të ardhmen e banorëve të saj, mbi një ekonomi të shëndoshë dhe të larmishme, por me fokus në shfrytëzimin e pasurive nëntokësore, turizmin historiko-kulturor e natyror dhe bujqësinë. Besojmë se diversifikimi i ekonomisë lokale do të sjellë një mirëqënie për gjithë shoqërinë dhe do të rrisë cilësinë e standardet e jetesës në territorin e bashkisë tonë.

Cilësia e jetesës në këto territore do të përcaktohet edhe nga manaxhimi i integruar i territorit me një qeverisje transparente për të ofruar shërbime dhe infrastrukturat përkatëse të nevojshme për çdo banor të Kuçovës.

Bashkia Kuçovë, përtej qëllimit ekonomik, synon të të krijojë një mjedis shoqëror të shëndetshëm nga i cili përfiton i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët mbizotëron; ku banorët jetojnë në harmoni me burimet natyrore, hapësirat publike dhe komunitetet e tjera që e rrethojnë.

Strategjia e Zhvillimit per Territorin e Bashkise Kuçovë:

Objektivi strategjik 3: *Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor, në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, duke valorizuar token bujqësore dhe elementët e forte natyrorë dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integrimit me potencialet rajonale turistike.*

Bashkia Kuçovë paraqet një situatë pozitive të lidhjeve të mundshme me rrjetin rajonal, jo vetëm në kontekst ekonomik, tregtar dhe të forcës punëtore, por edhe në këndvështrim të turizmit.

INVESTIME TË REALIZUARA GJATË 2018-2019 DHE INVESTIME NË PROCES:

1- Rikualifikim urban i lagjes " 11 Janari", realizuar plotësisht dhe financuar nga buxheti i shtetit në vlerën 144,379,556 lekë dhe nga buxheti i bashkisë në vlerën 28,795,326 lekë. Përfunduar dhe likujduar plotësisht.

2-Rikonstruksion i rrugës "Enver Bregu – Rreth Tapi Kuçovë" investim i realizuar plotësisht me fondet e Bashkisë. Vlera e plotë e këtij investimi është 35,353,488 lekë. Përfunduar dhe likujduar plotësisht.

3-Rikonstruksion i kopshtit nr. 1, investimi do të financohet plotësisht me fondet e bashkisë. Vlera e kontratës së këtij investimi është 8,003,586 lekë. Ky investim është kryer, likujdimi është në proces.

4-Përgatitja e projektit: Studim Projektim: "Rikualifikimi i Parkut Industrial (ish-TEC + Ndërtim/Montim)", investim i financuar plotësisht me fondet e bashkisë. Vlera e kontratës së këtij investimi është 6,240,000 lekë, fondet për likujdim janë parashkuar në buxhetin 2019. Kryer dhe likujduar plotesisht me të ardhurat e veta.

5-Rikonstruksion i Gjimnazit " 5 Tetori" investim i financuar 30% me fondet e bashkisë dhe pjesa tjetër nga Fondi Shqiptar i zhvillimit. Vlera e plotë e kontratës është 51,196,879 lekë. Investimi ka përfunduar dhe likujdimi është kryer plotësisht.

6-Ndërtim/shtesë kati Biblioteka Kuçovë, me vlerë të kontratës 7,181,787 lekë, është financuar nga Qeveria Zicerane, Austriake dhe nga Bashkia Kuçovë.

Punimet për këtë objekt kanë përfunduar dhe është likujduar plotësisht.

7-Rikualifikimi urban i lagjes "1 Maj", investimi në vlerë 109,428,189, do të financohet plotësisht nga të ardhurat e veta në vitet 2020-2021 dhe aktualisht punimet kanë përfunduar.

8-Projekti; "Rikonstruksion i banesave të komunitetit Rom dhe Egjiptian përfshirë zonat rurale" me vlerë kontrate 14,574,632 lekë, investimi ka përfunduar. Ky investim u financua plotësisht nga buxheti i shtetit.

9-Rikonstruksion i ish godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove të naftës dhe kthim në banesë sociale, me vlerë të kontratës 19,104,270 lekë. Ky investim ka përfunduar dhe është likujduar pjesësisht. Financimi i projektit është me fonde nga buxheti i shtetit.

-Rikualifikim i parkut industrial (ish-TEC + Ndërtim/ Montim), investimi do të financohet plotësisht nga buxheti i shtetit.

- **Për vitet 2020-2022 parashikohen për likujdim këto investime:**
  1. Rikualifikimi urban i lagjes "1 Maj", për këtë projekt është lidhur kontrata në vlerën 105,619,032 lekë. Punimet janë në proces dhe likujdimi është parashikuar të kryhet 400,000 lekë në vitin 2019, 54,497,207 lekë në vitin 2020 dhe 50,721,825 lekë në vitin 2021, nga të ardhurat e veta.
  2. Rikonstruksion i shkollës "18 Tetori", ky investim është në proces. Fondi i miratuar për projektin ishte 76,911,627 lekë. Kontrata është lidhur në vlerën 74,580,437 lekë. Financimi do të jetë si në tabelë:

Bashkia Kuçovë

ent	min	kod	Vlere e projektit	Viti 2019	Viti 2020
124	11	1880030	51,506,949	21,535,256	29,971,693
124	00	1240115	23,073,488	13,064,744	10,008,744
Totali			74,589,137	34,600,000	42,311,627

Pjesëmarrja e Bashkisë në këtë financim është 30%. Pjesa tjetër do të financohet nga FZHR.

3. "Rehabilitim/Përforcim banesash egzistuese të familjeve në nevojë", investim në proces dhe që do të financohet në vitet 2019-2020. Vlera e kontratës është 18,921,738 lekë, nga të cilat 14,189,265 lekë do të financohen nga buxheti i shtetit dhe 4,729,755 lekë do të financohen nga fondet e Bashkisë.

Programet e propozuara per Objektivin Strategjik 3;

- **Programi Strategjik O3P3**: Sistemimi në trajtë parku i zonës kodrinore të Njësisë Administrative Kozare, duke shfrytëzuar elementet ekzistuese të peisazhit, me funksion rekreacion dhe uljes së efekteve shqetësuese të zonës naftëmbajtese, do të financohet nga buxheti i shtetit, në kuadër të ristrukturimit të 100 fshatrave.
- **Programi Strategjik O3P6**: Përmirësimi i imazhit të qytetit si "qytet i naftës", duke valorizuar identitetin në shërbim të turizmit:

Projektet:

1. Ndërtimi i Muzeut të Naftës.Vlera e plotë e projektit shkon 45,000,000 lekë.

Gjithashtu Bashkia ka aplikuar tek KZHR dhe projektet INTERREG IPA:

Projektet:

1. Sinecl, destinacion i ri turistik!
2. Nxitja e ekonomisë lokale, nëpërmjet ruajtjes së aseteve kulturore të patjetërsueshme.

Kapitulli V. Financime nga partnerë dhe donatorë.

Lista e prioriteteve të investimeve për vitin 2020-2022:

Nr.	Emri i projektit	Financuesi /Vlera/ lekë	Dokumentat/ Projektet teknike
1	Ndertim shtese kati objekt ekzistues per strehim social me vlere 21 819 324	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim
2	Pastrimi dhe rehabilitimi i kanalit kullues në zonën pranë UPN, në seksionin Porta e Përpunimit-Hipotekë. I gjithë projekti arrin në vlerën 22,323,000 lekë.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë.	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim.
3	Ndertim i shkollës 9 vjecare Perondi. I gjithë projekti arrin në vlerën 55 259 496 lekë.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim.
4	Rikonstruksioni i kopshteve në Njësinë Administrative Lumas.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë, Bashkia	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim

Bashkia Kuçovë

5	Ndërtim KUZ Gegë. I gjithë projekti arrin në vlerën 134 424 239 lekë.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë, Bashkia	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim
6	SINECI, një destinacion i ri turistik! I gjithë projekti arrin në vlerën 198,156,003 lekë me TVSH.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim
7	Rikualifikimi urban i lagjes Llukan Prifti. I gjithë projekti arrin në vlerën 161 089 927 lekë me TVSH.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projektet janë të plota dhe gati për zbatim
8	Ndërtimi i rruges Kuçovë-Lumas. I gjithë projekti arrin në vlerën 550,000,000 lekë me TVSH	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekt-ideja është e plotë.
9	Rikualifikimi i rrugës Perondi-Lapardha. I gjithë projekti arrin në vlerën 123,605,449 me TVSH.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim
10	Rikualifikimi i rruges Fier Mimar-Havaleas. I gjithë projekti arrin në vlerën 141.598.243 me TVSH.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim
11	Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Bardhaj + Ndërtim i urës së fshatit. I gjithë projekti arrin në vlerën 124 445 310 me TVSH.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim
12	Ndërtim KUZ Drizë. I gjithë projekti arrin në vlerën 66.878 854 lekë.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë, Bashkia	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim
13	Rikonstruksioni i rrugës që të çon tek Njësia Lumas+ Ndërtim i Urës.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekti po punohet nga Drejtoria e Urbanistikes.
14	Rikualifikimi i rrugës Goraj-Velagosht.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekti po punohet nga Drejtoria e Urbanistikes.
15	Rikualifikimi i rruges Goraj-Qafa e Spitalit-rruga e Policisë.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekti po punohet nga Drejtoria e Urbanistikes.
16	Projekti për menaxhimin e mbetjeve urbane në nivel Bashkie, në kuadër të projektit rajonal,me synim riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve. Vlera e projektit 59,400,000 lekë.	SEKO, Bashkia Kuçovë	Projekti po punohet nga donatori dhe Bashkia.
17	Rehabilitimi i landfillit sanitar egzistues për depozitimin e mbetjeve urbane. Vlera e projektit Vlera e projektit 603,807 euro varianti i parë dhe varianti i dytë 458,348 euro.	SEKO, Bashkia Kuçovë	Projekti po punohet nga donatori dhe Bashkia.
18	Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative të zonave ripariane të Lumit Devoll, osum dhe Seman. Vlera e projektit 50,000,000 lekë.	Qeveria/FSHZH /Donatorë të tjerë	Projekti po punohet nga donatori dhe Bashkia.

	ndërtimi i tubacionit kryesor paralel me kanalin e dikatrës. I gjithë projekti arrin në vlerën 250.000.000 lekë.	të tjerë KFV	dhe gati për zbatim
20	Krijimi i stacioneve fikse të monitorimit ditor të cilësisë së ajrit në zona me aktivitet të lartë industrial si ajo e naftës. I gjithë projekti arrin në vlerën 2.800.000 lekë.	Qeveria/Donatorë të tjerë, Bashkia	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim
21	Zgjerimi i sipërfaqes së varrezave të qytetit Kuçovë. Vlera 30,000,000 lekë.	Bashkia Kuçovë.	Projekti është i plotë dhe gati për zbatim
22	Rikonstruksion i shkollave 9 vjeçare, Vodëz, "Shaban Plaku" Tapi dhe "Gaqi Karakashi".	Bashkia Kuçovë.	Vlera 59,380,558
23	Rikonstruksion rruge dhe ndërtim ure në fshatin Bardhaj.	Bashkia Kuçovë.	Vlera 124,445,310
24	Rikonstruksion i rrugës Perondi-Lapardha.	Bashkia Kuçovë.	Vlera 123,605,449
25	Rehabilitim i skemës së ujitjes Kozare-Perondi loti 2.	Bashkia Kuçovë.	Vlera 69,536,125
26	Rikualifikimi urban i lagjes " T.Skendo".	Bashkia Kuçovë.	Vlera 23,788,055
27	Ndërtim KUZ në fshatin Kozare.	Bashkia Kuçovë.	Vlera 98,505,958

Ky vendim u miratua me: 20 vota pro, — vota kundër, — abstenim të pranishëm 20 këshilltare.

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK
Migena BULLARI